



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor
“Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare”
i
Institucionit të Arsimit të Lartë “UNIVERSITETI EPOKA”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Dr. Merita Xhumari
2. Prof. Asoc. Dr. Afrim Krasniqi

Nëntor 2020

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për Programin e studimit: Bachelor në “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare”, ofruar nga Universiteti “EPOKA”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “EPOKA”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 281, datë 12.03.2008
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMASh Nr. 213, datë 25.05.2012
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASh Nr. 565, datë 22.11.2011
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 75, datë 21.09.2017
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10 PAE / 7 PAK
18	Numri i studentëve:	66
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare” (BA në ShPMN) ofrohet nga Departamenti i ShPMN si njësi bazë e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, Universiteti “EPOKA”, Tiranë. Programi në vlerësim zhvillohet në gjuhën angleze. Ai fillimisht u krijua me kohëzgjatje prej katër vitesh akademike (240 ECTS), riorganizuar me Urdhër nr.213 datë 25.05.2012 të MASH në studime 3 vjeçare (180 ECTS). Programi i ristrukturuar është riakredituar për një periudhë 3 vjeçare me Vendimin e BA nr. 75, datë 21.09.2017 me vlefshmëri deri më 30.09.2020.

Më 24.09.2019 ASCAL konfirmoi aplikimin e programeve të studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, duke njoftuar se periudha e vlerësimit është Mars-Shtator 2020. Sipas të dhënave të institucionit GVB për ri-akreditimin e programit të studimit Bachelor në ShPMN, u ngrit me Vendim nr. 17, datë 31.10.2019 të Senatit të Universitetit “EPOKA” dhe përbëhet nga personel akademik dhe administrativ, si dhe përfaqësues i studentëve. GVB hartoi dhe depozitoi RVB në Maj 2020.

Bazuar në procedurat standarde, ASCAL caktoi si ekspertë të jashtëm për vlerësimin e këtij programi Prof. As. Dr. Merita Xhumari dhe Prof. As. Dr. Afrim Krasniqi. Gjatë gjithë procedurës, ekspertët u asistuan nga përgjegjësia e sektorit Dr. Xhiliola Bixheku dhe specialistja e ASCAL Juna Mengri.



Reflektim mbi disa komente dhe shpjegime më të hollësishme të GVB të Universitetit EPOKA lidhur me disa nga vëzhgimet e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm

Mbi bazën e shpjegimeve më të hollësishme nga GVB, janë riformuluar disa konstatime të GVJ si në lidhje me Rekomandimin 2, nivelin e njohjes së gjuhës angleze nga studentët për të minimizuar diferencat që ata kanë në fillimet e programit. Po ashtu, sa i takon Standardit 2.4 del qartë mënyra e përditësimit të litaraturës bashkëkohore në programet e lëndëve, që pavarësisht se nuk i referohen teksteve të 5 viteve të fundit, përdorin artikuj që janë lehtësisht të aksesueshëm në librarinë e tyre online si për stafin akademik dhe studentët. Sa i takon Standardit 2.5, konstatimi i GVJ i referohet raporteve sasiore të PAE /PAK në dy vitet e fundit akademike, 2018-2019 dhe 2019-2020 ka një prirje të rritjes së peshës specifike në numër të PAK në masën 40% (5 pedagogë) në raport me PAE 60% (7 Pedagogë), krahasuar me vitin akademik 2017-2018. Referuar shpjegimeve në detaje të GVB, pavarësisht raporteve numerike, sa i takon ngarkesës së lëndëve të programit mësimor, PAE ka rritje në angazhimin mbi 80 % të lëndëve dhe PAK ka ulje në mbulimin e lëndëve të programit nga 15% në 2017-2018 në rreth 13% në dy vitet pasues akademike.

Lidhur me shkallën e përmbushjes së rekomandimeve nga akreditimi i mëparshëm, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka rishikuar formulimin e rekomandimeve si më poshtë vijon.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Në shtojcën e Vendimit të BA Nr. 75, datë 121.09.2017, ka patur dhe këto rekomandime:

1. Institucioni duhet të angazhojë staf të ri akademik të kualifikuar dhe me përvojë në këtë fushë, për mbulimin e plotë të ngarkesës akademike dhe mësimdhënies cilësore;
2. Institucioni duhet të vendos si një ndër kriteret e pranimit për studentët e këtij programi studimi njohjen në nivel të mirë të gjuhës angleze, ku përveç mesatares së gjuhës të ketë edhe një test të shkruar edhe të folur të kësaj gjuhe si parakusht për pranimin e tyre. Kjo duhet të shoqërohet me kurse të posaçme të kësaj gjuhe kryesisht gjatë semestrit dhe vitit të parë akademik;
3. Syllabuset e disa lëndëve duhet të rishikohen për t'u përditësuar dhe orientuar në kontekstin e tregut vendas të punës për këtë program studimi;
4. Literatura dhe tekstet në gjuhën angleze në funksion të programit të studimit, duhet të plotësohen edhe me literaturë vendase të fushës së programit në gjuhën shqipe;
5. Në kuadër të rekrutimit të stafit të ri akademik, Institucioni duhet të parashikojë kritere për përfshirjen edhe të stafit vendas me njohje në fushën e shkencave politike dhe marrëdhënie



ndërkombëtare të vendit për të mbuluar siç duhet hapësirën që nuk mund të mbulohet nga stafi akademik i huaj.

GJENDJA E PLOTËSIMIT TË KËTYRE REKOMANDIMEVE DHE KUSHTEVE:

a) Për rekomandimin 1.

Institucioni raportoi se e ka plotësuar rekomandimin duke angazhuar personel shtesë të kualifikuar për të mbuluar ngarkesën e punës akademike dhe mësimdhënien cilësore. RVB theksonte se programi ka shtatë (7) personel akademik me kohë të plotë të përkushtuar në mësimdhënie, dy (2) profesorë të Asociuar; dhe pesë (5) pedagogë me gradë PhD. Krahas tyre angazhon anëtarë të personelit akademik nga fakultete të tjera dhe personel akademik të kualifikuar me kohë të pjesshme. Nga verifikimet e GVJ rezultoi se të dhënat e RVB mbi përbërjen e stafit nuk përputheshin me të dhënat e DVV të raportuara nga institucioni.¹ Konkretisht, në vend të pesë (5) pedagogëve me gradë PhD në stafin akademik full time rezultojnë të jenë tre (3) PhD dhe dy (2) Msc për vitin akademik 2018-2019 dhe 2019-2020, që përmbushin kriterin e kërkuar. Njëri prej profesorëve pjesë e departamentit rezultoi të jetë Dekan full time në një fakultet tjetër brenda universitetit. Prurjet e reja në personel nuk e kanë shmangur ngarkesën disproporcionale midis stafit akademik, ndërkohë që në aspektin cilësor rezultoi se stafi akademik ka CV të pasur profesionale dhe kualifikime të ndryshme ndërkombëtare.

Shkalla e përmbushjes së rekomandimin nr. 1: Përmbushet plotësisht.

b) Për rekomandimin 2.

Institucioni deklaroi se e ka plotësuar tërësisht rekomandimin. Sipas institucionit në kriteret shtesë për praninë në programin Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare është njohja e gjuhës angleze në nivelin B1, përpara regjistrimit. Të gjithë studentëve u është kërkuar të dorëzojnë certifikatën e gjuhës angleze në një nga provimet standard ndërkombëtare dhe se provimi i aftësisë së gjuhës angleze i Universitetit “EPOKA” zhvillohet nga Këshilli Britanik në Shqipëri në ambientet e Universitetit. Nga komunikimi me studentët dhe verifikimet e tjera rezultoi se në tërësi ky kriter është plotësuar. Argumenti shtesë i GVB se bazuar mbi nivelin e njohjes të

¹ Tabela 1 dhe 2 tek Tabelat përmbledhëse për Anekset.

gjuhës angleze (B1, B2 ose C) të certifikuar, programi i studimit ofron dy lëndë në shërbim të kualifikimit të mëtejshëm gjuhësor të studentëve si më poshtë: Viti I/Semestri 1: ENG 107 Core English (për studentët me nivel B1 të njohjes të gjuhës angleze) dhe ENG 109 Developing Reading and Writing Skills (për studentet me nivel B2 dhe C të njohjes të gjuhës angleze). Viti I/Semestri 2: ENG 109 Developing Reading and Writing Skills (për studentët që kalojnë me sukses lëndën ENG 107 Core English) dhe ENG 106 Advanced English (për studentët që kalojnë me sukses lëndën ENG 109 Developing Reading and Writing Skills). Në këtë mënyrë arrihet rritja e nivelit të njohjes së gjuhës angleze dhe eliminimi i diferencave midis studentëve, duke siguruar që në përfundim të vitit të parë të studimeve, të gjithë studentët të kenë arritur nivelin C të njohjes së gjuhës angleze.

Shkalla e përmbushjes së rekomandimit nr. 2: Përmbushet plotësisht.

d) Për rekomandimin 3.

Institucioni deklaron se e ka plotësuar tërësisht rekomandimin. Institucioni vuri në dispozicion të dhëna studimore në vite për studentët dhe raportet me tregun e punës, si dhe një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione dhe biznese të njohura në vend. Nga verifikimet e GVJ rezultuan se ekzistojnë të dhëna të përmirësuara për lidhjen midis studimeve dhe tregut të punës, zhvillimin e panairëve me kompani të njohura, si dhe është rritur numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit. Lidhur me sugjerimin që syllabuset e disa lëndëve duhet të rishikohen për t'u përditësuar dhe orientuar në kontekstin e tregut vendas të punës për këtë program studimi ka ende vend për përmirësime. Gjatë takimeve, sidomos me studentët, u konstatua se prioritet mbetet adresimi në organizatat, institucionet dhe tregun ndërkombëtar dhe se lidhja me kontekstin vendas reflektohet në një pjesë të syllabuseve.

Shkalla e përmbushjes së rekomandimit nr. 3: Përmbushet plotësisht

c) Për rekomandimin 4.

Institucioni dhe departamenti deklaruan se kanë rishikuar programet, literaturën dhe kanë pasuruar bibliotekën me botime edhe në gjuhën shqipe/mbi Shqipërinë. Programi ka nevojë për specifikime të orëve të seminarit dhe praktikave profesionale të cilat janë zero. Orët në total janë 4500 që i korrespondojnë 180 krediteve, por që mungon një ndarje e orëve teorike me orët praktike dhe praktikatat profesionale/ praktikatat në terren. Për shkak të fokusimit të universitetit literatura themelore mbetet në gjuhën angleze sepse gjuha e mësimin në programin e studimit është anglisht. Nga të dhënat e mbledhura nga GVJ rezultoi se është bërë progres në drejtim të zgjerimit të titujve



shqip dhe literaturës mbi Shqipërinë, pavarësisht fokusit anglisht dhe në marrëdhënie ndërkombëtare. Disa prej lëndëve kanë fokus direkt zhvillimet në Shqipëri dhe së paku ato mund e duhet të kenë literaturë të plotë referuese. Stafit u ofron studentëve literaturë shtesë shqip, por studentët i deklaruan GVJ se nuk e përdorin literaturën shqip dhe kanë pak interes për të.

Shkalla e përmbushjes së rekomandimit nr. 4: Përmbushet kryesisht.

d) Për rekomandimin 5.

GVJ konfirmon se institucioni e ka plotësuar tërësisht rekomandimin. Personeli lokal i angazhuar në programin Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare përbëjnë shumicën e anëtarëve të personelit akademik, tërheqja e personelit akademik nga trojet shqiptare është vlerë e shtuar pozitive për këtë departament e program, si dhe harmonizimi i personelit akademik të huaj me stafin vendas është gjithashtu një tregues pozitiv.

Shkalla e përmbushjes së rekomandimit nr. 5: Përmbushet plotësisht



VLERËSIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR
“SHKENCA POLITIKE DHE MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare është në përputhje të plotë me interesat kombëtare dhe përcaktimet e legjislacionit shqiptar. Studimet promovojnë vlerat e demokracisë, shtetit të së drejtës, integritit evropian, si dhe i gjithë aktiviteti është në sinkron me përgjegjësitë e përcaktuara në "Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015- 2020".
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Në vlerësimin tonë konfirmojmë se programi i studimit është në përputhje të plotë me vlerat akademike dhe kulturore të RSH dhe si pjesë të saj edhe me politikat kombëtare të përcaktuara në "Strategjinë Kombëtare të Arsimit të Lartë" të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Programi promovon vlerat e demokracisë, lirisë, të menduarit kritik, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, ndihmon në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare shqiptare, si dhe në promovimin e kulturës dhe traditës shqiptare edhe për personelin e huaj akademik dhe studentët e huaj.
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Ba në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare është në përputhje me "Statutin e Universitetit “EPOKA” të miratuar më 14.12.2016, me Planin Strategjik 2017-2022 dhe atë 2018-2022, në të cilat theksohet se misioni i programit është të vendosë standarde në përmbajtjen akademike dhe cilësinë e mësimdhënies, pajisja e studentëve me aftësitë e nevojshme për t'u marrë me çështjet bashkëkohore, sigurimi i trajnimeve të përparuara akademike për studentët, dhe promovimi

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	i kërkimeve në nivelin më të lartë. Në vlerësimin e GVJ programi mësimor Ba në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në EPOKA dallon nga programet e njëjta të universiteteve e shkollave të larta në Shqipëri për specifikën e tij në marrëdhëniet ndërkombëtare, për harmonizimin midis stafit akademik të huaj, nga zonat shqipfolëse dhe vendor, si dhe me zhvillimin në gjuhën angleze të programit.			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi i studimit është hartuar duke respektuar nevojat e tregut të punës dhe interesin publik në Shqipëri, si dhe duke qenë në përputhje me prioritetet e zhvillimeve sociale dhe ekonomike të Shqipërisë. Programi ndërthur njohuri të shkencave politike, të marrëdhënieve ndërkombëtare, të studimeve juridike dhe ekonomike, të gjuhëve të huaja dhe të praktikës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Kriteri është përmbushur dhe institucioni ka përcaktuar qartësisht se programi është hartuar dhe ofruar në përputhje dhe në zbatim me Strategjinë e zhvillimit të institucionit 2017-2022 dhe Strategjinë 2018-2022. Qëllimet e këtyre dokumenteve janë të udhëzojnë zhvillimin e programit të studimit në përputhje me standardet bashkëkohore kombëtare, evropiane dhe ndërkombëtare.
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në	Statuti i Institucionit, Rregullorja e institucionit dhe Rregullorja e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, përcaktojnë drejtimit prioritar akademike, qëllimet, misionin mënyrën e përmbushjes së përgjegjësive dhe shërbejnë si bazë për programin e studimit. Sipas dokumenteve referuese prioritet akademik është përcaktuar synimi që Universiteti EPOKA të veprojë si një institucion arsimor dhe kërkimor inovativ dhe me ndikim; duke shërbyer vlerat themelore njerëzore përmes prodhimit, zhvillimit

përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	dhe shpërndarjes së njohurive në një nivel ndërkombëtar; si dhe duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës së shoqërisë bazuar në nevojat kombëtare dhe rajonale.			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	GVJ bie dakord me vlerësimin se në hartimin e programit të studimit, konsiderohet se emërtimi i programit të studimit, organizimi, struktura dhe përmbajtja është në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të institucionit. Sipas Vendimit të Senatit të Universitetit “EPOKA” Nr.12, datë 28.09.2017 është krijuar Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, brenda të cilit operon si strukturë e mirë-organizuar Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Programi përkon me Nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	Programi i studimit u mundëson studentëve të pajisen me aftësi për analizë kritike të njohurive në fushën e shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, të mendojnë në mënyrë kritike, të jenë krijues dhe të pavarur në opinionet e tyre, si dhe të angazhohen në praktika mësimore dhe institucionale në funksion të harmonizimit të studimeve teorike me aplikimet praktike. Studentët pajisen me nivel të avancuar teorik dhe të dijeve mbi zhvillimet politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare në Shqipëri, rajon e botë, si dhe trajtojnë çështje që kanë të bëjnë me raste historike, por edhe me aktualitetin në marrëdhëniet ndërkombëtare.
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që	Bazuar në vendimmarrjet mbi akreditimin institucional dhe dy akreditimet e mëparshme të programit të studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare rezulton se institucioni ka pasur dhe vijon të ketë studime të tregut të punës

<p>ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>sidomos lokal, si dhe ka një databazë të plotë dhe aktive të studentëve në vite në raport me angazhimet e tyre profesionale pas studimeve. Pjesa më e madhe e studentëve bachelor vijojnë studimet master, një pjesë edhe studimet jashtë vendit, ndaj edhe vlerësimi që lidh punësimin, tregun e punës dhe programin e studimit është pjesë e vlerësimit të plotë institucional pas tre cikleve të studimit.</p> <p>GVJ konstatoi aktivitete të ndryshme të ndërmarra në funksion të studentëve dhe tregut të punës, përfshirë panairë pune, ditë të dedikuara të takimeve me biznesin, zhvillimin e praktikave në kompani e institucione të njohura, etj. Gjithashtu Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe për Studentët e Diplomuar (ZPKSD) është funksionale dhe aktive përmes këshillimit, informimit të vazhdueshëm, koordinimit, asistencës dhe zhvillimit të pyetësorëve me studentët e diplomuar.</p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të nxënies, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit BA në ShPMN në të gjithë elementët e tij (struktura, përmbajtja, etj), si dhe metodikën që përdor në dhënien e dijeve, testin e tyre, lidhjet mes teorisë e praktikës, etj, u mundëson studentëve plotësimin e një profili të lartë profesional në funksion të nevojave dhe kërkesave të tregut të punës. Duke qenë program i bazuar në studimet në gjuhën angleze, me personel kombëtar e ndërkombëtar, me programe mësimore të avancuara dhe me fokus studimor kombëtar e ndërkombëtar, programi i plotëson standardet e këtij kriteri. Në funksion të studentëve institucioni ka një sistem informimi e mbështetje të vazhdueshëm, promovon lidhjet me tregun si dhe i asiston vazhdimisht në ambiciet e tyre akademike dhe referencat brenda e jashtë vendit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Universiteti “EPOKA” është nga universitetet e pakta në vend që ofron diploma në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në të tre ciklet e studimit, duke përfshirë Bachelor, Master (Master Profesional dhe Master i Shkencave), dhe PhD. Programi zhvillohet në gjuhën angleze, stafi akademik është shqiptar dhe i huaj, literatura kryesisht e huaj. Bazuar në treguesit e deritanishëm (akreditimi i vazhdueshëm institucional dhe i programeve), si dhe në bilancin universitar të vazhdimësisë në vite dhe në tre nivele, vlerësojmë se institucioni ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e nevojshme në funksion edhe të programit Bachelor në ShPMN. Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare përbëhet nga shtatë (7) anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë, nga të cilët dy (2) mbajnë gradën shkencore profesor i Asociuar, tre (3) “Doktorë” dhe dy (2) Msc për vitin akademik 2019-2020 (Referuar Aneksit 1, Tabela përmbledhëse, Tabela 1). Programi gjithashtu angazhon anëtarë të personelit akademik nga fakultete të tjera të Universitetit Epoka. Personeli akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2019-2020 janë respektivisht 1 Prof.Dr, dy (2) mbajnë gradën shkencore Profesor i Asociuar, një (1) “Doktorë” dhe një (1) Msc, gjithsej 5. Raporti 7 PAE/5 PAK për vitin akademik 2019-2020 mbetet i njëjtë sikurse viti i mëparshëm 2018-2019, dhe në të dy këto vite është përkeqësuar në raport me vitin akademik 2017-2018 ku raporti ka qenë 10PAE/4PAK, pra është zvogëluar numri i PAE. Në aspektin cilësor rezulton se stafi akademik ka CV të pasur profesionale dhe kualifikime të ndryshme ndërkombëtare.</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të</p>	<p>Studimet në Bachelor në Shkenca Politike dhe në Marrëdhënie Ndërkombëtare janë në përputhje me fushën akademike të njësisë bazë, Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, dhe të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, si dhe më tej edhe të Universitetit. Bazuar në të dhënat strukturore të institucionit, Fakulteti përbëhet nga tre njësi bazë (2 departamente dhe 1 qendër kërkimore), përkatësisht Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Departamenti i Drejtësisë, si</p>

<p>programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>dhe Qendra për Studime Evropiane. Njësitë me kapacitetet dhe me specializimin e tyre në fushat e shkencave juridike, politike dhe studimeve evropiane, vijnë si plotësuese për studime në fushën e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Kodifikimi kombëtar i programeve të studimit, siç parashikohet nga dispozitat e Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Nenit 86, nuk është aprovuar ende nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Sidoqoftë, që nga themelimi i tij, Universiteti "EPOKA" ka zbatuar kodifikimin e vet të programeve dhe lëndëve të studimit në përputhje me fushën e veçantë të studimit.</p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Të dhënat e mësipërme vlejné edhe për këtë kriter. Programi i studimit ofrohet në kuadër të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale dhe është në përputhje të plotë me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, Departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, me kërkesat e legjislacionit për arsimin e lartë në Shqipëri, si dhe me procesin evropian të Bolonjës dhe me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Kodifikimi kombëtar i programeve të studimit, siç parashikohet nga dispozitat e Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" Nenit 86, nuk është aprovuar ende nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Lidhur me programet ndërdisiplinore, lëndët ofrohen nga njësitë bazë bashkëpunuese brenda Universitetit "EPOKA" dhe secila lëndë mban kodin e njësisë bazë që e ofron.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Universiteti “EPOKA” e ushtron aktivitetin e tij në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, konfirmuar nga akreditimi i vazhdueshëm institucional. Dokumentet rregullatorë, si Statuti i Universitetit, Rregullore e Fakulteteve, etj, përcaktojnë dhe sigurojnë marrëdhënie bashkëpunimi në institucion, duke ndarë detyrat dhe përgjegjësitë, analizën dhe vlerësimin e vazhdueshëm, si dhe sistemin e karrierës bazuar mbi meritat. Organet kryesore dhe personeli akademik kanë mbështetjen e plotë nga struktura administrative e institucionit. Grupi i vlerësimit të jashtëm evidentoi kontratat e personelit dhe vlerësimet periodike të tyre nga njësitë përgjegjësive respektive.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Institucioni ofroi të dhëna të detajuara të programeve shkëmbimore brenda e jashtë vendit, si dhe të marrëveshjeve të partneritetit me institucione shqiptare e të huaja. Marrëveshjet sipas dokumentacionit të universitetit janë 39 me institucione akademike (kryesisht jashtë vendit) dhe 41 me institucione jo akademike (kryesisht brenda vendit). Lista e plotë e marrëveshjeve institucionale iu vu ne dispozicion GVJ gjatë vizitës në institucion. Një pjesë e madhe e tyre nuk lidhet direkt me studimet në këtë program, megjithatë GVJ konstatoi se edhe studentët dhe stafi akademik i programit Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare kanë qenë dhe janë pjesë e projekteve të ndryshme të përbashkëta, përfshirë programe shkëmbimi, konektiviteti, Erasmus, Horizont 2000, etj. Studentët konfirmuan zhvillimin e praktikave profesionale në institucione të ndryshme në vend si të qeverisjes qendrore (Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme), njësitë e qeverisjes vendore, ashtu dhe në institute kërkimore dhe organizata të shoqërisë civile.</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit</p>	<p>Departamenti konfirmoi se harton raporte analitike në funksion të bilancit të bashkëpunimit midis institucionit dhe partnerëve në marrëveshje. Gjatë takimeve edhe me studentët u konfirmua</p>

harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	edhe databaza e studentëve me përfitimet në kuadër të projekteve dhe bashkëpunimit të universitetit (departamentit) me institucione në Shqipëri dhe ndërkombëtare, veçanërisht u përmendën projektet e bashkëpunimit me njësitë e qeverisjes vendore.			
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Në kuadër të bashkëpunimit institucioni ka realizuar marrëveshje për kryerjen e praktikave nga studentët. Referuar Aneksit 1, Tabela Përmbledhëse, Tabela nr.5, pjesë e marrëveshjeve dhe e praktikës janë edhe institucioni i parlamentit, ambasada të shteteve evropiane në Tiranë, OJF, institucione dhe biznese të mëdha. Praktika nuk është e detyrueshme në kuadër të programit mësimor, por është pjesë e politikës së departamentit dhe të institucionit. Praktika kryhet gjatë periudhës së pushimeve verore, kur edhe studentët nuk cenohen në angazhimet e tyre akademike.			
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Institucioni mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar të cilët janë urë lidhëse për organizimin e lidhjeve mes universitetit dhe institucioneve ku ata janë punësuar, duke u përfshirë në veprimtari të ndryshme të universitetit. Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare bazuar në kalendarin vjetor të veprimtarisë, i paraqitur në "Shtojcën Nr. 53", mbështet trajnime profesionale përmes leksioneve të hapura, forumeve dhe debateve për tema të aktualitetit dhe të tjera me interes reciprok.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1

Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>GVJ vlerëson se kurrikula e programit të studimit BA në ShPMN është e organizuar me lëndë dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Referuar planit mësimor të Programit të studimit Bachelor në ShPMN, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 5 kategori nga A-E, në përputhje me VKM 41 datë 24.01.2018, ku janë të specifikuara në lëndë të detyrueshme dhe në lëndë me zgjedhje. Programi i studimit Bachelor në ShPMN ka një kohëzgjatje normale prej tre vitesh akademike dhe përfundon me 180 ECTS, programi zhvillohet në anglisht dhe ofron ndërthurje të njohurive të thelluara mbi politikën e marrëdhëniet ndërkombëtare, me konceptet mbi ekonominë dhe drejtësinë.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi mësimor është hartuar në përputhje me Nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve bazuar në Ligjin nr. 10247, datë 04.03.2010 "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve", të ndryshuar. Studentët në përfundim të studimeve të tyre në Bachelor fitojnë njohuri të thelluara profesionale mbi politikën, marrëdhëniet ndërkombëtare, por edhe njohuritë bazë mbi qeverisjen, marrëdhëniet publike, ekonominë dhe drejtësinë. Programi u krijon mundësinë studentëve të kenë një fushë të gjerë studimesh të avancuara në dy programet Master Shkencor e Profesional, ose në kërkimin e tregut të punës pas studimeve Bachelor.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Përmes programit Bachelor studentët marrin njohuri profesionale dhe fitojnë aftësitë e kërkuara rreth mekanizmave të politikës kombëtare dhe ndërkombëtare, të historisë, të drejtësisë, lexim kritik të fenomeneve sociale dhe një nivel të lartë të aftësive analitike. Studentët janë gjithashtu të ekspozuar ndaj debateve të fundit teorike dhe teknikave metodologjike sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Nga biseda me studentët ata ishin konfidentë për të vazhduar studimet edhe jashtë vendit, sikurse një pjesë e të diplomuarve të mëparshëm. Po ashtu stafi akademik ishte aktiv në veprimtari ndërkombëtare e publikime të fundit.</p>




<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi, duke qenë në nivel Bachelor nuk mund të ofrojë zgjidhje të problemeve komplekse dhe të paparashikueshme, por mund dhe ia ka arritur që në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve të aftësojë studentët për mendim profesional, të menduarit kritik, për menaxhimin e aktiviteteve dhe projekteve, për trajtim teknik dhe profesional të çështjeve, si dhe të marrin përgjegjësi për të qenë pjesëmarrës në aktivitete ndërkombëtare, në projekte dhe në nisma të ndryshme në kuadër të partneritetit.</p>			
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>GVJ vlerëson se elementet e programit të studimit BA në ShPMN janë në përputhje të plotë me VKM nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar, ai dhe me aktet e tjera ligjore në fuqi, përfshirë me kriteret e MARS dhe ASCAL Programi ka një kohëzgjatje normale prej tre vitesh akademike dhe plotësohet me 180 ECTS, mësimi është me kohë të plotë dhe në anglisht. Pas përfundimit të studimeve, studentit i jepet grada "Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare".</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Analiza e të dhënave mbi lëndët, ngarkesat përkatëse në kredite dhe kategoritë e përcaktuara në kurrikulën e programit tregon se ato janë gjithashtu në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse. Bazuar në VKM nr 41 datë 24.01.2018 veprimtaria formuese e kategorisë D është më e ulët se përcaktimi i saj në VKM (duhet të jetë 10-15 % të ECTS, ndërkohë nga llogaritja del që është 8.3 %). Ndarja semestrare, grupimi i lëndëve, harmonizimi me staf akademik nga drejtësia dhe ekonomiku, gjithashtu janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullat e institucionit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Analiza e Statutit të Universitetit, Rregullores së funksionimit të programit, si dhe dokumenteve të tjera ligjore mbi të cilat zhvillohet aktiviteti i njësisë bazë/kryesore, tregojnë se ajo i plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 25 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare është pjesë e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale. Fakulteti përbëhet nga tre njësi bazë. BA në ShPMN ka marrë akreditimin e parë periodik bazuar në Vendimin Nr. 75, datë 21.09.2017 të Bordit të Akreditimit, të ndryshuar me Vendim Nr. 75/1, datë 13.07.2018. Për shkak të natyrës së organizimit, drejtuesi i njësisë bazë ashtuedhe drejtuesi i fakultetit nuk zgjidhen, por emërohen nga bashkëpunimi i organeve më të larta vertikale (Përgjegjësi i Departamentit me propozim të Dekanit dhe Dekani nga Rektori dhe Bordi Drejtues).</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Institucioni ka caktuar përgjegjës të departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare si koordinator akademik i programit të studimit Bachelor në ShPMN. Caktimi i tij është i përshtatshëm për përgjegjësinë që koordinatori të informojë titullarin e njësisë bazë. Institucioni raporton se çdo vit akademik, departamenti cakton gjithashtu një këshilltar akademik për secilin grup studentësh, i cili është përgjegjës të aprovojë regjistrimin e lëndëve të marra nga studentët çdo fillim semestri, si dhe të sigurojë udhëzime akademike për studentët gjatë gjithë semestrit.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për</p>	<p>Departamenti, si njësia bazë përgjegjëse për ndjekjen e të gjitha fazave të programit, i përmbush detyrimet e tij që burojnë nga aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe nga dokumentet statusore dhe rregullatore brenda institucionit. Sikurse specifikohet edhe më sipër, referuar tabelës 1 në Aneksin 1 Tabelat Përmbledhëse, të RVB, numri i stafit akademik me kohë të plotë (7) dhe me kohë të pjesshme (5), pra në raportet 60 % stafi me kohë të plotë</p>

organizimin dhe strukturën akademike.	dhe 40% me kohë të pjesshme, ku raportet sipas titujve e gradave shkencore janë: 0 (zero) Prof.Dr PAE/1(një) Prof.Dr. PAK; 2 (dy) Prof.Assoc PAE/ 2 (dy) Prof.Assoc PAK; 3 (tre) Dr.PAE/1 (një) Dr. PAK. Për dy vitet e fundit akademike situata ka qenë e njëjtë, kurse krahasuar me vitin akademik 2017-2018 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit ka një situatë ku numri i stafit akademik efektiv është reduktuar nga 10 (2017-2018) në 7 (2019-2020; 2018-2019).			
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.	Departamenti ka shtatë (7) anëtarë efektivë, nga të cilët dy (2) janë profesorë të Asociuar, tre (3) janë “Doktor” dhe dy (2) janë Msc. Këto të dhëna janë në përputhje me nenin 25, pika 4, Ligji 80/2015. Nga verifikimi i të dhënave GVJ konstatoi mospërputhje midis të dhënave të deklaruara nga institucioni (http://79.106.71.62/ams/components/dokumentat/proceduravi_eë.php?id=49984), me të dhënat për stafin të publikuara në faqen zyrtare të institucionit ku rezultojnë dy Doktorë. dhe 4 Msc (http://epoka.edu.al/flss-academic-staff.html),			
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Fakulteti përfshin 2 (dy) departamente: 1) i Drejtësisë dhe 2) i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Njësia e tretë është Qendër kërkimore (Qendra për Studime Evropiane). Departamenti, si njësia bazë përgjegjëse për ndjekjen e të gjitha fazave të programit, i përmbush detyrimet e tij që burojnë nga aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe nga dokumentet statutore dhe rregullatore brenda institucionit. Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare përmbush kriterin e stafit akademik prej 7 anëtarësh, nga të cilët vetëm dy janë me Master Shkencor, tre Doktorë dhe dy Prof.Assoc.Dr.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare zotëron të gjitha informacionet në lidhje me programin mësimor dhe programin e kurseve të BA në ShPMN. Të gjitha informacionet u konfirmuan nga GVJ dhe gjenden edhe në databazën e ASCAL. Po ashtu, kjo u konfirmua jo vetëm nga biseda me stafin akademik të Departamentit, por edhe nga takimet me studentët dhe njësitë e tjera mbështetëse të Universitetit.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi Bachelor në ShPMN përmban 35 lëndë. Lëndët dhe ngarkesa përkatëse e tyre brenda kurrikulës janë në përputhje të plotë me dispozitat e Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar. Programi nuk aplikon praktikë të detyrueshme.</p> <p>Programi i studimit organizohet sipas elementëve dhe krediteve sipas kategorive si më poshtë:</p> <p>A- 42 ECTS - 23.3% B- 92 ECTS – 51.1% C- 25 ECTS – 13.8 % D- 15 ECTS – 08.3 % E- 6 ECTS – 03.3 %</p> <p>Bazuar në VKM nr. 41 datë 24.01.2018, Shtojca Nr 1 Kategoria D nuk përmbush kriterin (duhet të jetë 10-15 %).</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi ka të organizuar lëndët dhe modulet sipas standardeve ligjore dhe sistemit të krediteve me 180 ECTS. Lëndët dhe modulet janë ndarë sipas semestrave në 3 viteve të studimit. Për të dy semestrat e vitit të parë dhe të dytë, si dhe semestrin e parë t vitit të tretë, lëndët janë përcaktuar në mënyrë të njëjtë me nga 5 ECTS, me përjashtim të semestrit të gjashtë, semestri i fundit i vitit të tretë, ku ka jo 6 por 5 lëndë me nga 6 ECTS secila prej tyre. Këtu ka vend për rishikime, në kuptimin e vlerësimit të rëndësisë së lëndëve karakterizuese e formuese të programit të cilat mund të kenë një peshë specifike më të madhe referuar krediteve, krahasuar me lëndët e tjera. Po ashtu, kreditet nuk i referohen orëve të mësimit për çdo lëndë, të cilat variojnë nga 45 orë në 60 orë, por që kreditet në të dyja rastet janë të njëjta.</p>

	Po t'i referohemi Aneksit me Tabelat Përmbledhëse, Tabela 10, orët e mësimit dalin që nuk janë 45 po 48 mësim në auditor dhe 64 jo 60 orë mëm në auditor, të cilat duke u plotësuar me orët e mësimit jashtë auditorit plotësojnë 125 orë = 5 kredite. Ka nevojë për përputhje në të dhënat për orët mësimore sipas lëndëve: 45 apo 48 dhe 60 apo 64 referuar tabelave nr.4 dhe nr.10 në Aneksin e Tabelave Përmbledhëse.
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Programi është i detajuar në të dhënat që lidhen me planin mësimor, ngarkesën mësimore, orët, frekuentimin, ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. Nga shqyrtimi i Planit Mësimor jepen informacione në lidhje me ngarkesën mësimore , orët në auditor dhe jashtë tij për çdo lëndë. Përsa i përket mënyrës së vlerësimit të dijeve i gjejmë të specifikuar në syllabuset e lëndëve. Kryesisht vlerësimi bazohet në një sërë indikatorësh përfshirë testet paraprake apo në mes të semestrit, ese, prezantime, punë në grup, projekte dhe provimi final, që tregon metodat e larmishme të përdorura gjatë procesit mësimor. Sa i takon vlerësimit në lidhje me frekuentimin, jo të gjitha syllabuset e kanë të specifikuar, në disa raste vlerësimi për frekuentimin zë 10% të vlerësimit të notës finale.
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi ka të gjithë informacionin e duhur adresuar studentëve mbi kriteret e përgjithshme, specifikat e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Rregullat e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit Bachelor në ShPMN janë të parashikuara në Rregulloren e Universitetit Epoka. Kjo u konfirmua edhe nga biseda me studentët që kanë realizuar mobilitetin nga Universiteti EPOKA apo që kanë ardhur këtu nga universitete të tjera të vendit apo jashtë vendit. Po ashtu, rregjistrat e sekretarisë pasqyronin saktë numrin e studentëve të pranuar dhe atyre të transferuar vit pas viti. Rregjistrat ishin pa korrigjime dhe me të dhëna të plota për studentët, referuar dosjeve të tyre me të cilat GVJ bëri disa shqyrtime.
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore	Programi i përmban të gjitha informacionet e nevojshme të kërkuara në këtë kriter të cilat janë të shpallura e të aksesueshme edhe në faqen online të universitetit. Syllabusi përmban informacionet e nevojshme të detajuara në lidhje me objektivat

(syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	e lëndës, tematikat, seminarët si dhe orët brenda apo jashtë auditorit në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018. Gjithashtu syllabuset e lëndëve përcaktojnë edhe sesi përcaktohet nota përfundimtare për lëndën bazuar në totalin e vlerësimeve për testet paraprake apo në mes të semestrit, esetë dhe prezantime, projektet dhe provimin final. Syllabuset kanë të njëjtin format dhe kanë të specifikuar literaturën (Aneksi për syllabuset).			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Sipas praktikës së punës së institucionit në fund të çdo viti akademik, bëhet rishikimi i programit të studimit, ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme - përfshirë ndryshimet e kurrikulave. Programi i studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare nuk ka bërë ndryshime në planin mësimor në vitet akademike 2017-2020 (referuar Aneksit 1, Tabelat Përmbledhëse, Tabela 11).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi BA në ShPMN është strukturuar me 180 ECTS në total, çdo 1 ECTS përbëhet nga 25 orë ngarkesë, ngarkesa në auditor si dhe ngarkesa e nevojshme për studim individual, duke qenë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kjo ngarkesë ndahet në mënyrë proporcionale në 6 semestra me 30 ECTS secili.
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë,	Programi në tërësi përbëhet nga lëndë që adresojnë qëllimin e tij në formësimin e dijeve teorike e aftësive praktike dhe që janë në përputhje me fokusimin në tregun e punës të studentëve të diplomuar e në zhvillimin social dhe politik të

<p>njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Shqipërisë. Studentëve u kërkohet rregullisht që të përgatisin projekte, detyra dhe ese. Lëndët me zgjedhje përbëjnë 20% të kurrikulës së programit të studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare. Lëndët bazë ofrohen kryesisht gjatë vitit të parë dhe të dytë të studimeve në këtë program studimi për të vijuar me lëndët më specifike në vitin e tretë të studimeve. Në kurrikulën e programit të studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, lëndë bazë si Hyrje në Marrëdhënie Ndërkombëtare (PIR 131 Introduction to International Relations) ose Hyrje në Shkenca Politike (PIR 111 Introduction to Political Science) ofrohen semestrin e parë të vitit të parë të studimeve si lëndë me detyrim .</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Elementët përbërës të programit (lëndët, shpërndarja në semestra e vite, kreditet, etj), e mundësojnë arritjen e objektivave të tij. Semestri i parë fillon me hyrje në njohuritë në shkencat sociale, kryesisht në shkencat politike, sociologji dhe fushën e legjislacionit e diplomaci, të plotësuara këto me kurset me zgjedhje që kryesisht ofrojnë gjuhë të huaja dhe shkrim akademik. Pastaj vazhdohet me histori të mendimit politik e diplomacisë dhe në semestrin e tretë, pra vitin e dytë Bachelor futen lëndë si metodat e kërkimit dhe politikat e institucionet në BE dhe në Shqipëri. Në semestrin e katërt i kushtohet rëndësi politikave në Ballkan, studimit të ekonomisë si vazhdim i semestrit të tretë dhe studimit të partive politike dhe sistemeve zgjedhore. Semestri i pestë fokusohet në njohuritë mbi demokracinë, politikën e jashtme dhe procesin e politikbërjes dhe në simestrin e gjashtë futen edhe lëndë të tjera, krahas gjuhëve të huaja, në lëndët me zgjedhje. Lëndët janë përcaktuar në mënyrë të njëjtë me 5 ECTS, me përjashtim të semestrit të gjashtë ku ka 5 lëndë me 6 ECTS secila prej tyre. Këtu ka vend për rishikime.</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e</p>	<p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre është në përputhje me profilin e programit “Bachelor”, duke pasur si risi të tij fokusimin në marrëdhëniet ndërkombëtare, mësimin anglisht dhe stafin e ndërthurur kombëtar e ndërkombëtar. Raporti teori-praktikë anon nga teoria pasi programi nuk</p>

programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	aplikon praktikë mësimore, gjithsesi formimi në 3 vite i lejon studentët të marrin konceptet dhe aftësitë e nevojshme profesionale.
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Programi BA në ShPMN ka ndërthurje pozitive midis veprimtarisë formuese dhe trajtimit të çështjeve konkrete të politikës dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare. Ai mundëson arritjen e objektivave formues, për transferimin e studimeve, mobilitet, etj, konfirmuar edhe nga raste konkrete të studentëve që kanë vazhduar studimet në Evropë dhe SHBA prej formimit të tij. Orët mësimore sipas planit mësimor (Aneks 1, Tabelat Përmbledhëse, Tabela 10), ndahen në 1856 orë mësimi në auditor (vetëm leksione / zero orë seminari), dhe 2580 orë studimi jashtë auditorit dhe 64 orë tema e diplomës. Këtu programi ka nevojë për specifikime të orëve të seminarit dhe praktikave profesionale. Orët në total janë 4500 që i korrespondojnë 180 krediteve, por që mungon një ndarje e orëve teorike me orët praktike dhe praktikat profesionale.
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Institucioni aplikon rishikimin e përditësimin e literaturës dhe të lëndëve. Sipas shpjegimeve të GVB, në rastet kur mungon literatura bazë e përditësuar (kur vëllimi i fundit i botuar daton para 5 vitesh), por edhe kur literatura bazë është e përditësuar, stafi akademik përdor si literaturë mbështetëse artikuj shkencorë të publikuar në 5 vitet e fundit në revista shkencore me faktor impakti dhe të indeksuar në Clarivate Analytics.
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	Programi i studimit garanton marrjen e njohurive, aftësive dhe kompetencave të synuara në nivelin bachelor. Referuar programit me lëndët respektive në çdo semestër, njohuritë vijnë duke u thelluar dhe zgjeruar nga një semestër në tjetrin, nga hyrjet në njohuritë në shkencat sociale, me histori të mendimit politik e diplomacisë dhe politikat e institucionet në BE, deri në konceptet e demokracisë. Njohuritë përforcohen me zhvillimin e aftësive dhe kompetencave me lëndë si shkrimi akademik, metodat e kërkimit dhe gjuhëve të huaja.
Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose	Programi u jep studentëve njohuritë që mund të merren në një sistem bachelor, i ndihmon ata për studime të avancuara, si dhe asiston ambiciet e studentëve për angazhime profesionale drejt tregut të punës. Stafi akademik dhe studentët sollën dy

punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	shembuj studentësh që kishin vazhduar studimet Master në universitetet në Evrope dhe SHBA.			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Përmes programeve institucionale dhe mekanizmave të brendshëm, si zyra e Planifikimit të Karrierës, anketimeve me studentët e diplomuar, forumeve dhe panaiereve, njësi bazë dhe institucioni konsultohen vazhdimisht me propozimet për nevojat dhe pritshmëritë e tregut të punës. Duke bërë rregullisht gjurmimet e studentëve të diplomuar dhe përmes marrëdhënieve të ngushta me një larmi subjektsh dhe aktorësh vendas dhe të huaj që janë të angazhuar në fushën e veprimtarive politike dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare, stafi akademik përshtat syllabuset dhe departamenti programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5 Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme të angazhuar në program përmbushin kërkesat ligjore. Të dhënat për personelin akademik si dhe biseda me gjithë stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi si me kohë të plotë, ashtu dhe me kohë të pjesshme, gjatë vizitës në institucion konfirmojnë se ata përmbushnin kërkesat ligjore. Dy nga pedagogët në pamundësi për të qenë prezentë në takim, qëndruan në lidhje me skype gjatë orarit të takimit me stafin akademik. GVJ konstatoi se shqetësimi i vetëm mbetej ngarkesa disproporcionale midis stafit akademik dhe sidomos praktikantët e caktimit të një ligjëruesi për 5-7 lëndë, të cilat do të kërkonin njohuri të thelluara në më shumë se 2-3 fusha studimore.




	<p>Një pjesë e pedagogëve part time janë nga fakultetet e tjera brenda të njëjtit institucion, dhe se departamenti duhet të përcaktojë qartësisht ndarjen e stafit të brendshëm full time të Departamentit të Shkencave Politike me stafin që është full time në kuadër institucional. Në dy vitet e fundit akademike, 2018-2019 dhe 2019-2020 ka një prirje të rritjes së peshës specifike në numër të PAK në masën 40% (5 pedagogë) në raport me PAE 60% (7 Pedagogë), krahasuar me vitin akademik 2017-2018. Referuar shpjegimeve në detaje të GVB, sa i takon ngarkesës së lëndëve të programit mësimor, PAE ka rritje në angazhimin mbi 80 % të lëndëve dhe PAK ka ulje në mbulimin e lëndëve të programit nga 15% në 2017-2018 në rreth 13% në dy vitet pasues akademike. Studentët ishin vlerësues për cilësitë e stafit akademik si një nga kriteret për zgjedhjen e këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik ka kualifikimin e nevojshëm për të mbuluar cilësisht lëndët dhe për të përmbushur detyrimet e programit. Risia e programit, - harmonizimi i stafit akademik të huaj me atë shqiptar, si dhe midis shqiptarëve edhe nga zona shqipfolëse, të gjithë me CV profesionale, përbën risi pozitive dhe ndikon në cilësinë e standardin e mësimin. Një shqetësim i konstatuar nga GVJ lidhet me ngarkesat mësimore, ku kishte pedagogë me ngarkesë vjetore deri në 7 lëndë të ndryshme, përballimi me sukses i të cilëve kërkon ekspertizë shumëdimensionale. Rishikimi i ngarkesave të tilla dhe shpërndarja e lëndëve sipas formimit të stafit akademik do të ishin sugjerime për rritjen e cilësisë dhe standardeve të institucionit.</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Niveli i kualifikimit të personelit akademik të programit të studimit BA në ShPMN është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. Fusha akademike dhe ajo kërkimore e personelit akademik me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme që mbulon programin e studimit përkojnë me lëndët dhe kërkimet që ata zhvillojnë aktualisht. CV e personelit mund të gjendet në Shtojca nr. 20).</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Në bazë të kurrikulës së programit të studimit BA në ShPMN, studentëve iu ofrohet udhëheqje në përgatitjen e Praktikës Profesionale për diplomim (Shtojca nr. 86). Programi i studimit BA në ShPMN sipas legjislacionit në fuqi përfundon me provim diplome dhe vetëm në raste sporadike me punim diplome. Studentët praktikat profesionale i zhvillojnë në periudhën e pushimeve verore, jo gjatë vitit akademik, po në çdo rast disponibiliteti i stafit akademik për të qenë i disponueshëm ndaj nevojave të studentëve përbën një karakteristië dalluese të institucionit të theksuar nga studentët gjatë bisedës me ta në institucion.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni angazhon rregullisht asistentët, sipas programit mësimor dhe detyrimeve të përcaktuara në departament. Për vetë natyrën e këtij programi nuk ka laboratorë me përjashtim të atyre për gjuhët e huaja.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Institucioni ka të përcaktuar në dokumentet kryesore strategjike angazhimin në rritjen e cilësisë dhe standardeve të mësimdhënies, duke përdorur arritjet më të fundit teknologjike dhe shkencore, duke krijuar sistem efikas të lidhjes të teorive me studimin e rasteve praktike, duke nxitur bashkëpunimin me institucione homologe, forumet e hapura me studentët, personalitete të ftuar, etj. Sipas të dhënave të institucionit dhe të konstatuara edhe nga GVJ në takimet me stafin akademik dhe studentët, ka politika të qarta për përmirësimin e vazhdueshëm të metodologjisë mësimore të mësimdhënies si dhe të zhvillimit të qasjes inovative dhe krijuese.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Departamenti dhe strukturat e tjera brenda institucionit kanë mekanizma monitorimi e vlerësimi të cilësisë, të punës së çdo kërkuesi dhe stafi akademik, të projekteve dhe të problematikave të ndryshme të mësimdhënies. Mbi bazën e tyre mësimdhënia dhe aftësitë inovative të personelit akademik vlerësohen rregullisht për të siguruar dhe / ose përmirësuar cilësinë e të diplomuarve për sa i përket njohurive dhe aftësive të fituara. Zyra e personelit dhe studentët konfirmuan vlerësimet për stafin akademik.
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Sipas praktikës së konsoliduar të institucionit çdo fund semestri studentët marrin pjesë në “Anketën e Vlerësimit të Instrukturëve të Lëndës” përmes të cilës maten treguesit cilësore dhe profesionale të stafit akademik, të moduleve dhe të sesionit akademik. Studentët janë pjesëmarrës aktivë dhe e konsiderojnë këtë si një instrument konstruktiv ndërveprimi.
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Të gjitha rezultatet e anketës për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie përfshihen në analizën e raportit vjetor të institucionit, si dhe gjetjet kryesore bëhen publike online në faqen e institucionit. Detajet që lidhen me stafin akademik nuk bëhen publike, por rast pas rasti adresohen në departament ose

	tek personeli direkt i stafit akademik. Të dhënat kryesore bëhen publike edhe në vlerësimin periodik në kuadër të procesit të monitorimit nga ASCAL.			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	Përmes mekanizmave institucional të vlerësimit, si dhe trajnimeve, konferencave etj, institucioni prezanton dhe stimulon praktikat e mira të mësimdhënies. Institucioni gjithashtu bazuar në performancë mbështet edhe stafin akademik në promovimin individual, përfshirë pjesëmarrjen në konferenca dhe botimet profesionale jashtë vendit. Stafi akademik konfirmoi mbështetjen e institucionit për pjesëmarrje në veprimtari shkencore, të cilat planifikohen rregullisht që në fillim të vitit akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Programi mësimor zhvillohet përmes një kombinimi të leksioneve, seminareve, detyrave të lëndës, projekteve dhe aktiviteteve të tjera, sikurse u konfirmua nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, bisedave me stafin akademik dhe studentët. Leksionet e hapura, debatet publike me ekspertë të ftuar njohur të njohur, si dhe forumet profesionale dhe në nivel studentor janë pjesë e formave të mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve. Institucioni ka një faqe interneti shumë të pasur në informacion dhe me akses të plotë në sistemin e brendshëm nga studentët dhe stafi akademik. Rol pozitiv në këtë drejtim luan "Qendra për Studime Evropiane".
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e	Institucioni ndër vite ka dëshmuar aftësi të bashkëveprimit në diversitet kulturor të stafit akademik, duke krijuar një klimë pozitive dhe mbështetëse për krijimin e klimës së përshtatshme të diversitetit edhe tek studentët. Në program ka edhe studentë të huaj që studiojnë, ka studentë që kanë jetuar

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>vite jashtë vendit dhe kanë kryer në vende të ndryshme studimet parauniversitare, etj, duke krijuar një mjedis të hapur, bashkëveprues dhe nxitës midis studentëve. Institucioni ka asistuar përmes trajnimeve mbi forma të debatit, të negociatave dhe zgjidhjes së problemeve brenda lëndëve si dhe në veprimtaritë jashtë-programore, etj. Në funksion të harmonisë dhe diversitetit janë kryer vizita studimore në Kosovë (2018), Greqi (2019), dhe programuar vizitë Belgjika (2020, pamundësuar për shkak të COVID-19).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Institucioni ka programe dhe politika të qarta për stafin akademik, përfshirë mbështetjen financiare dhe institucionale për pjesëmarrje në konferenca, në projekte ndërkombëtare, në vizita studimore, në trajnime mbi mësimdhënien dhe mbi sfidat e kërkimit shkencor të personelit akademik. Institucioni boton (jo rregullisht) një revistë shkencore dhe punimet kërkimore publikohen edhe në faqen online. Në shtator 2019 institucioni organizoi aktivitetin "Trainimi mbi Arsimin Dixhital" (Shtojca nr. 79) me përfaqësuesit e shtëpisë botuese ndërkombëtare "Pearson", ku personeli u trajnuar me platformën e tyre të personalizuar të përmbajtjes së lëndës që përfshinte mësimin ndërveprues, mjetet e reja të vlerësimit, burimet dixhitale dhe aplikacionet dhe burimet e tjera të krijuara për të ndihmuar studentët të arrijnë më shumë.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik i programit ka në mesin e tij individë me merita të njohura akademike brenda dhe jashtë vendit, me botime profesionale dhe me aktivitete shumëvjeçare në kërkime shkencore. Stafii vjen nga përvoja akademike në vende të ndryshme dhe me përvojë të gjatë profesionale, çfarë i mundëson atij të zotërojë njohuritë e nevojshme në funksion të jetësimit të programit. Rekrutimi i stafit të ri bëhet me konkurs dhe bazuar në merita profesionale. Departamenti ka bërë përpjekje për të krijuar lidhje të qëndrueshme midis stafit akademik dhe moduleve/lëndëve kryesore. GVJ konstatoi se shqetësimi i vetëm mbetet ngarkesa disproporcionale midis stafit akademik dhe sidomos praktikave të caktimit të një ligjëruesi për 5-7 lëndë, të cilat do të kërkonin njohuri të thelluara në më shumë se 2-3 fusha studimore. Konkretisht,</p>

	<p>një nga pedagogët e stafi akademik me kohë të plotë ligjëron 4 lëndë të detyrueshme të programit si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Demokracia dhe demokratizimi 2. Komunikimi Politik 3. Politika dhe institucionet në BE 4. Analiza dhe menaxhimi i krizave... 			
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Matja dhe vlerësimi i formave dhe metodikës së mësimdhënies realizohet përmes anketës së vlerësimit çdo fund semestri nga studentët, si dhe formës tradicionale të prezencës të autoritetit drejtues gjatë realizimit të leksionit/orës së mësimi. Përmes këtyre dy mekanizmave institucionale dhe formave të tjera praktike realizohet marrja e opinioneve nga stafi e studentët, si dhe diskutimi i tyre për të ndërmarrë hapa përmirësues për të ardhmen. Mendimi i studentëve për përmirësime merr vëmendje dhe reflektohet, - vlerësim që u konfirmua edhe nga takimi i GVJ me studentët.</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Sipas institucionit, 85% e lëndëve në programin e studimit përfshijnë metoda interaktive dhe diskutim gjatë orëve të mësimi. Kjo e dhënë konfirmohet përmes analizës së syllabuseve, ku vend të rëndësishëm në vlerësim dhe në jetësimin e lëndës i jepet prezantimeve në klasë, diskutimeve, projekteve ose analizave të studimeve të rasteve, si pjesë e vlerësimit të suksesit të studentëve. Biseda me studentët konfirmoi interesin e tyre për mësimin e realizuar përmes metodave interaktive.</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Pavarësisht se lënda e metodës së kërkimit shkencor është lëndë e vitit të dytë, që në fillim të studimeve studentët kanë mundësi të përfitojnë nga asistenca e institucionit përmes orëve këshilluese, ushtrimit të orëve autoriale nga stafi akademik, këshillimi akademik, etj. Studentët janë të nxitur të bashkëveprojnë midis tyre dhe të aplikojnë për pjesëmarrje në sa më shumë praktika, trajnime, konferenca etj, për të nxitur tek ata ballafaqimin e njohurive të tyre me praktikën, pavarësinë në veprim e mendim krijues, si dhe konkurrencën pozitive në karrierë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Mjediset ku zhvillohet programi janë të cilësisë dhe standardeve të larta, konfirmuar edhe nga proceset e akreditimit të vazhdueshëm institucional dhe të programeve në “Epoka”. Pastërtia ishte mbresëlënëse, ndonëse universiteti ishte në kushtet e veprimtarive të kufizuar në auditor për shkak të situatës COVID-19.
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Përmes mekanizmave institucionalë, siç është edhe Zyra Koordinimit të Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (ICTC) ofrohen shërbime informatike të nevojshme në varësi nga kërkesat e programit. Mjediset ku zhvillohet mësimi kanë sistem funksional interneti dhe prezantimi me monitor, në funksion të stafit akademik dhe studentëve.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	I gjithë stafi akademik dhe studentët kanë të drejtë të përdorin vazhdimisht instrumentet e informimit dhe kërkimit të avancuar në sistemin online të universitetit, në network-un e stafit akademik e studentor mundësuar nga Zyrën e Koordinimit ICTC, në biblioteka online, etj.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të	Studentët kanë mundësi që të njihen që në fillim të studimeve me lëndet, stafin akademik dhe literaturën e detyrueshme dhe fakultative. Ata kanë akses edhe në leksionet e pedagogëve dhe të dhëna profesionale që vijnë nga punime shkencore, konferenca, etj. Studentët mund të shfrytëzojnë bibliotekën e institucionit dhe atë online të siguruar përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit. Nga biseda me studentët, GVJ krijoi përshtypjen se studentët e përdorin në mënyrë të kufizuar aksesin online,

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

parashikuara në programin e studimit.	kryesisht për shkak se studimet bachelor krijojnë në vazhdimësi një ide të qartë të studentëve mbi konceptet shkencore dhe mendimet alternative.
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Biblioteka ka një kapacitet mesatar të botimeve, por për shkak të natyrës së programit vendin kryesor e zënë literatura online sidomos ajo ndërkombëtare, e cila sigurohet me akses të hapur për studentët. GVJ konstatoi se në bibliotekë ka pak prurje nga botimet e reja të viteve të fundit (në shqip) lidhur me shkencat politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Universiteti ka anëtarësim në JSTOR, dhe çdo anëtar i stafit akademik mund të ketë akses në këto koleksione për të lexuar ose shkarkuar disa artikuj në mënyrë periodike.
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Në nivel institucional universiteti raportoi se ka gjithsej 128 kompjuterë për studentë, 4 laboratorë të mobiluar me PC, të cilat patëm rastin t'i shihnim gjatë vizitës në institucion, të gjitha në dispozicion të studentëve, edhe atyre të programit Ba në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare. Studentët konfirmuan se janë përdorues të rregullt të tyre në varësi nga nevojat universitare dhe akademike.
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Institucioni, përveç masave të zakonshme që mundësojnë platforma online të komunikimit, gjatë 2020 aplikoi masa të jashtëzakonshme për shkak të COVID-19. Dokumenti i detajuar i të dhënave iu vu në dispozicion GVJ. Nga GVJ u konstatua se Zyra e Koordinimit ICTC siguronte programet e nevojshme për të shërbyer për cilësinë e mësimdhënies në programin e studimit. Aty përfshihen sistemi i menaxhimit të mësimimit (LMS), sistemi i automatizimit të bibliotekës (KOHA) që është një sistem i integruar i bibliotekës me burim të hapur; DSpace (paketë

	softuerësh), si dhe turnitin, një program kompjuterik që kontrollon plagjiaturën.			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Përmes sistemit interaktiv online(EIS) përdoruesit, staf akademik e studentë, mund të regjistrohen duke përdorur email-in zyrtar të universitetit për komunikim dhe ndërveprim online në funksion të programit. Ai është një sistem modular i organizuar nga role dhe njësi përkatëse në universitet dhe informacioni ruhet në një bazë të dhënash të centralizuar.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Sipas përgjegjësi të përcaktuara në rregulloren e punës në departament dhe në funksion të cilësisë së mësimdhënies në program, stafi akademik asiston, mbështet, udhëzon dhe mbikqyr vazhdimisht rastet e përzgjedhjes, realizimit dhe mbrojtjes së diplomave nga studentët. Prezantimi i tyre bëhet në departament përpara përfundimit të studimeve bachelor. Vlen të theksohet se diploma Bachelor nuk kërkon mbrojtjen e një teme diplome, por të një provimi final, sipas ndryshimeve në Ligjin 80/2015. Gjithsesi institucioni ka të përcaktuar qartë dokumentin “THESIS WRITING GUIDELINE” (2017) për orientimin e studentëve në temën e diplomës. http://epoka.edu.al/mat/Thesis-Writing-Guide.pdf			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të	Institucioni përmes disa mekanizmave, përfshirë Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) investohet në monitorimin, mbështetjen dhe promovimin e vazhdueshëm të metodikave dhe formave të reja të mësimdhënies. Përmes të dhënave të tyre dhe raporteve të cilësisë, përmes manualit të

<p>mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>sigurimit të cilësisë dhe metodikës së përmirësimit të vazhdueshëm institucioni dhe njësitë në funksion të tij, rishikon, analizon dhe përmirëson programe e studimit. Pjesë e aktiviteteve janë edhe raportet periodike, analiza e tyre, anketimi, etj.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Sipas Statutit të Institucionit, Departamenti, si njësi bazë, është përgjegjës për mirëfunksionimin e programeve përkatëse të studimit, si dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve përkatëse të studimit. Departamenti e realizon këtë përmes disa konsultimit me kurrikulat ndërkombëtare, referuar marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitete të huaja dhe përvojave të sjella nga stafi akademik i diplomuar jashtë vendit. Departamenti përmes aktiviteteve në auditor dhe jashtë tij, i favorizuar nga një numër i vogël i studentëve të regjistruar në programin e studimit, siguron një ndërveprim më të drejtpërdrejtë midis studentëve dhe pedagogëve dhe ndjekjen e ecurisë së tyre dhe vetëdijes për cilësinë e programeve të studimit që ofron.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Departamenti dhe institucioni mbështesin format inovative të mësimdhënies duke nxitur përdorimin teknologjik, prezantimet, shkëmbimet profesionale, esetë konkurruese, punën krijuese dhe mendimin kritik, pjesëmarrjen në projekte kërkimore brenda e jashtë vendit, leksionet e hapura, bashkëveprimi me ekspertë, praktikant në institucione, etj.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Personeli akademik mbështetet jo vetëm me trajnime të vazhdueshme, përfshirje në projekte, vizita studimore, etj, por institucioni ka një politikë të qartë stimuluese mbështetëse për stafin akademik në punën e tyre si kërkues shkencorë, në pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare, në botime ndërkombëtare, në aplikimin prej tyre të projekteve që përfshijnë metoda kërkimore, etj. Universiteti mbështet botimet shkencore të pedagogëve të tij dhe inkurajon zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta kërkimore. Përmes këtyre formave jetësohet edhe qëllimi i kërkimit shkencor që të përgatisë akademikë dhe ekspertë me njohuri të specializuara në fushat e tyre të interesit.</p>

<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Institucioni përmes Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë organizon trajnime vjetore kushtuar nevojave mësimore të personelit akademik, përmirësimin të aftësive mësimdhënëse dhe zbatimit të metodave të reja.</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Bazuar me Statut, Rregullore dhe kontratat e punës, stafi akademik dhe ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve, si dhe përmes sistemit të vlerësimit ata angazhohen edhe për përmirësimin e mësimdhënies. Nga biseda me stafin akademik, të brendshëm e të jashtëm, GVJ konstatoi pasionin e tyre për të rritur cilësinë e mësimdhënies duke u njohur me të rejtat e metodave shkencore.</p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Nga të dhënat e mbledhura nga GVJ rezulton se stafi akademik dhe personeli ndihmës akademik marrin pjesë në trajnime dhe aktivitete në mënyrë periodike në funksion të njohurive të reja lidhur me mësimdhënien, analizën e saj dhe idetë novatore. Secili pjesëmarrës raporton gjetjet e tij gjatë ushtrimit të përgjegjësisë tek njësia bazë, departamenti.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të</p>	<p>Rregullorja dhe aktet e tjera rregullatore të programit dhe institucionit, si dhe vetë përmbajtja e detajuar e syllabuseve</p>




njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	përcaktojnë mënyrat dhe standardet e testimit të vlerësimit për studentët. Aktet janë publike dhe gjenden online për studentët, të cilët vihen në dijeni që në kontaktin e parë edhe përmes 'Udhëzuesin Smart të studentëve' dhe seancave orientuese dhe përmbajtjes së syllabuseve.			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Praktika e punës në institucion është konform detyrimeve ligjore lidhur me informimin e studentëve mbi metodologjinë e vlerësimit. Të gjithë studentët informohen në mënyrë të detajuar në orët orientuese dhe në prezantimet e para të lëndëve/moduleve. Takimi me studentët e konfirmoi një praktikë të tillë për tri vitet e studimit.			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Në praktikën dhe standardet e institucionit dhe të programet e studimit, njohuritë e studentëve sipas lëndëve dhe specifikave të tyre vlerësohen duke u bazuar në vlerësimin për (1) detyra shtëpie, (2) provim në mesin e sezonit, (3) prezantim, (4) projekt, (5) kuitz, (6) provime laboratorike / praktike, (7) rast studimi, (8) term paper, (9) provim përfundimtar dhe (10) pjesëmarrje. Sipas institucionit leksionet kanë edhe opsionin "tjetër" që mund të kenë nevojë në rast se dëshirojnë të vlerësojnë aftësitë e studentit përmes një metode tjetër që nuk përkrahët në listë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Bazuar në analizën e detajuar të syllabuseve të këtij programi studimi, në bisedat me stafin akademik dhe studentët gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm gjatë gjithë vitit akademik. Në lëndë të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	ndryshme të këtij programi aplikohet testimi i njohurive përmes provimit të ndërmjetëm dhe atij përfundimtar, si dhe gjatë periudhës tjetër të vitit akademik ka kontrolle të vazhdueshme të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale që lidhen me prezantime, detyra kursi, ese, etj, në varësi nga natyra e lëndës dhe përmbajtja e syllabusit të tyre.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Programi ashtu si e gjithë praktika e institucionit bazohet në formatin e provimeve të printuara, paraqitjen e detyrave në formë elektronike / print, etj. Vlerësimet depozitohen online në sistemin EIS përmes të cilit studentët menaxhojnë procedurat e lidhura me universitetin dhe kursin. Çdo student ka profilin dhe aksesin personal, si dhe rezultatet janë transparente edhe për stafin akademik, në mënyrë që sistemi të jetë jo vetëm informativ, por edhe transparent dhe jo abuziv.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Programi dhe institucioni kanë një sistem vlerësimi të provimeve bashkëvepruese me studentët; pas provimit ata njihen me përgjigjet e sakta dhe mund të kontrollojnë përgjigjet e tyre dhe të vlerësojnë performancën e tyre. provimet mbulohen nga lektori i lëndës dhe një staf ndihmës mbështetës në varësi nga natyra e lëndës.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Institucioni dhe programi sigurojnë anonimat e fletëve të provimeve. Çdo student merr një kod të personalizuar për secilën periudhë provimi, për të cilin ka dijeni vetëm koordinatori i departamentit. Kodet mundësojnë futjen e notës dhe vlerësimit në sistemin EIS dhe vetëm pas hedhjes së të dhënave bëhet lidhja midis vlerësimit dhe emrit të studentit. Sallat e provimeve gjithashtu vëzhgohen nga një sistem i kamerave të sigurisë që shërbejnë si provë në rast të ndonjë parregullsie.
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar	Përgjatë vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, në varësi nga natyra e lëndës, pas çdo provimi stafi përgjegjës akademik jep komentet dhe sugjerimet lidhur me përmirësimet të ndryshme të procesit të të nxënës nga studentit. Sistemit të vlerësimit është transparent në mënyrë që studentit të jetë më i qartë në vlerësimin që ka marrë. Në nivel institucioni dekanati emëron një ekspert për Programin e studimit për të vlerësuar cilësinë e provimeve, qëllimi kryesor

<p>studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>i të cilit është të sigurohet një mekanizëm i kontrollit të dyfishtë në drejtim të vlerësimit të duhur të aftësive të studentëve. Ajo çfarë u kërkua nga studentët ishte që të mos organizoheshin në një ditë dy provime të lëndëve të ndryshme sepse kjo nuk lejonte përqendrimin e tyre maksimal në një lëndë. Po ashtu studentët e vlerësuar me rezultate të larta kërkuan që ato të reflektoheshin në bursat që institucioni ofronte, të cilat lidheshin kryesisht me rezultatet e hyrjes në universitet dhe jo me rezultatet e provimeve.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Institucioni dhe programi kanë rregulla strikte kundër plagjiaturës apo kopjimit në provime dhe detyra. Sipas akteve rregullatore të institucionit çdo rast i dyshuar trajtohet përmes një komisioni të pavarur disiplinor. Institucioni përdor edhe programin Turnitin si një mekanizëm që kontrollon plagjiaturën për të gjitha detyrat me shkrim, nga shtëpia, deri te tezat e diplomës.</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Provimet dhe testimet me studentët bazohen në kontrollin e dijeve dhe rezultatet e tyre pasi hidhen në sistem depozitohen në departament së bashku me dokumentacionin e detajuar. Hedhja në sistem përmes programit EIS garanton transparencë dhe siguri, si dhe respekton të dhënat personale. Dosja përfundimtare e provimit përmban edhe çelësin e përgjigjes, një kopje të pikave të provimit përfundimtar dhe dy kopje të notave përfundimtare. Procedurat janë të parashikuara në aktet rregullatore të institucionit dhe të programit.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Sipas Rregullores "Për Studimet e ciklit të parë dhe Provimet", studentët mund të apelojnë brenda javës rezultatin e një provimi përfundimtar përmes kërkesës në Zyrën e Sekretarisë Mësimore. Praktika është e garantuar dhe studentët e konfirmuan atë në takimin me GVJ.</p>
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Rregullorja parashikon aktet e verifikimit dhe vendimmarrjes pas ankesës së studentëve. Komisioni vlerësues vlerëson kundërshtimin në lidhje me gabimet materiale dhe harton një raport, i cili i dërgohet Dekanatit për vendimin përfundimtar për ankesën. Zyra e Sekretarisë Mësimore ndjek, dokumenton dhe arkivon procedurën e përgjithshme</p>

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit ofron njohuri dhe aftësi të përshkruara në detaje në përshkrimin e syllabuseve dhe dokumentacionit shoqërues të programit. Studentët kanë mundësi të marrin njohuri të thelluara dhe të zhvillojnë aftësinë profesionale në varësi nga pasioni, angazhimi, dhe angazhime të tjera plotësuese, ku bëjnë pjesë edhe forumet e hapura, turnetë e debateve, konferenca studentore, projekte sociale dhe udhëtime studimore.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Sipas të dhënave të programit, 1 lëndë me 3 ECTS është lëndë e tipit “E” që në këtë program është lëndë e gjuhëve të huaja (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe turqisht). Krahas tyre studentët do ishte mirë të marrin edhe njohuri në fushën e teknologjisë së informacionit, të cilën mund ta aplikojnë lehtësisht në dy sallat moderne të laboratorëve me kompjutera. Gjithsesi studentët në lëndën e Metodave Kërkimore që zhvillohet në Semestrin e tretë marrin njohuri për dy software, SPSS dhe Nvivo me qëllim hedhjen dhe përpunimin e të dhënave të marra nga përdorimi i metodave të kërkimit sasior.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Çdo anëtar i stafit akademik në fund të semestrit analizon edhe ecurinë e lëndës, rezultatet e arritura dhe parashikon ndërhyrje përmirësuese ose plotësuese në varësi nga rezultatet dhe sugjerimet e studentëve. Të dhënat diskutohen me studentët dhe merren në shqyrtim në nivel departamenti.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli	Në përfundim të çdo moduli dhe semestri stafi akademik informon studentët mbi gjetjet kryesore dhe vlerësimet e

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	përgjithshme të lëndës/modelit. Përmes kësaj forme pedagogu përmbledh dhe diskuton me studentët si të përmirësojnë marrjen e njohurive, metodologjinë e përdorur dhe aspekte të tjera të rëndësishme për kursin.
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Sipas të dhënave të institucionit dhe nga takimi i GVJ me stafin akademik rezultoi se ai është vazhdimisht i angazhuar në aktivitete shkencore jashtë programit të studimit. I gjithë stafi ishte pjesë e projekteve, angazhimeve dytësore profesionale, nismave, etj. Universiteti planifikonte mbështetjen nga buxheti për aktivitetet e çdo pedagogu.
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Për vetë natyrën e programit lëndët e tij mbahen në auditore dhe të gjithë pedagogët përdorin teknologji gjatë mësimin. Në raste specifike, sidomos në trajnime dhe ushtrime që lidhen me projektet, leksionet mund të përdorin laboratorë dhe mjete të tjera mësimore. Programi nuk ka praktika profesionale megjithëse një pjesë e studentëve i ndjekin ato në mënyrë vullnetare gjatë sesionit të pushimeve të verës.
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Praktika e debatit dhe vendimmarrjes në departament është e bazuar në punën në grup. Kjo nxitet edhe nga fakti se një pjesë e madhe e lëndëve trajtojnë tematika e çështje të përafërta dhe plotësuese me njëra tjetrën, për të cilat ka disa anëtarë të stafit akademik të kualifikuar.
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Stafi akademik dhe departamenti inkurajojnë studentët të zhvillojnë ide inovative në detyra të projektit, të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre shkencore në seminare dhe konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Të tilla janë nismat për pjesëmarrje e mbështetje në projekte specifike rajonale e kombëtare, konferenca, trajnime, etj., të konfirmuara gjatë bisedës me studentët.
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Institucioni, përmes Zyrës së Koordinimit të Studentëve (ZKS) u ofron studentëve informacion dhe mbështetje në zhvillimin e ideve novatore dhe aftësi të tjera. Në nivel institucional janë 22 klube të financuara nga institucioni. Studentët mbështeten me bursa financiare, si dhe në varësi nga rasti dhe rëndësia edhe me mbështetje financiare në rast pjesëmarrje e botimi në aktivitete të treta. Një nga kërkesat

	e studentëve ishte që bursat të mos lidhen vetëm me rezultatet e shkollës së mesme, por të akordohen edhe mbi bazën e rezultateve në universitet.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Departamenti ka prioritet angazhimin profesional në network-e dhe në programe shkëmbimi me universitete të tjera evropiane dhe amerikane, si dhe me programe të ndryshme ndërkombëtare, në funksion të nxitjes së mobilitetit. Institucioni dhe programi i studimit ofruan të dhëna konkrete të shkëmbimeve semestrale të studentëve me universitete perëndimore. Vetë studentët kishin pritshmëri të larta për të vazhduar programet Master jashtë vendit, madje kjo ishte edhe një nga arsyet e zgjedhjes së këtij Universiteti ku studimet realizohen në gjuhën angleze.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Standardi III.8				
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Rregullat dhe procedurat e provimit përfundimtar ose mbrojtjen e diplomës janë publike dhe me akses online nga studentët dhe stafi akademik. Ato gjenden në faqen online të institucionit, si dhe u bëhen të ditura studentëve edhe gjatë fillimit të programit/vitit akademik. Lektorit përgjegjës plotëson syllabusin për lëndën përfundimtare të provimit gjithëpërfshirës dhe ua shpërndan studentëve në fillim të afatit.			
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Në funksion të asistimit të studentëve dhe transparencës institucioni u shpërndan studentëve një broshurë me 200 pyetje në total, nga 9 lëndë kryesore të kurrikulës. Provimi i fundit përfundimtar gjithëpërfshirës është përgatitur nga këto pyetje. Në rastin e diplomës, çdo lektor punon me studentin e caktuar përkatësisht në mënyrë të pavarur. Lektorët janë përgjegjës të ndajnë të gjitha materialet që mund të ndihmojnë studentin të kryejë punën e tij / saj të diplomës.			
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike,	Provimi final përmbledh njohuritë e tre viteve të studimit dhe lektorët e secilit kurs të përzgjedhur japin 20 pyetje për secilën lëndë të shoqëruar nga çelësi përkatës i përgjigjes. Lista e lëndëve nga të cilat rrjedhin pyetjet përfshin 3 lëndë kryesore nga secili vit.			

duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Teza e diplomës dhe provimi përfundimtar regjistrohen si lëndë me lektorë të caktuar përkatës. Lektori plotëson syllabusin për lëndën dhe pjesë e programit mësimor janë seanca konsultimi dhe udhëzimi me studentët.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në varësi nga natyra, tematika dhe rastet studimore, institucioni vendos infrastrukturën shkencore në dispozicion të studentit për të kryer matjet e nevojshme dhe për të arritur objektivat dhe fushën e studimit.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Bazuar në praktikën e konsoliduar akademike të institucionit, udhëheqësi i diplomës/tezës është përgjegjës për të asistuar dhe udhëhequr studentin gjatë gjithë fazës deri në mbrojtjen e saj. Në konsultim me studentin, udhëheqësi merr vendimin nëse studentin është i gatshëm të paraqesë punën e tij / saj para Jurisë.
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentin vlerësohet me notë.	Sipas praktikës, studentin merr notën në përfundim të provimit final ose tezës së diplomës nga pedagogu përgjegjës për koordinimin. Vlerësimi i temës së diplomës së studentit përbëhet: 70% nga vlerësimi i mbikëqyrësit të tezës dhe 30% nga vlerësimi i komisionit.
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studentin pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Sipas Rregullores përcaktohen kriteret dhe procedurat e diplomimit, përfshirë edhe pajisja me diplomë dhe me suplementin e diplomës pas përfundimit të studimeve, sipas modelit të miratuar nga MASR.
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Zyra e Sekretarisë Mësimore, në përfundim të studimeve pajis studentin me diplomën, me kopje të plotë të programit të studimeve të zhvilluara dhe rezultatet arritura.

Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Bazuar në aktet ligjore dhe në dokumentet rregullatore të institucionit, ai ruan në arkiv kopje të dokumentacionit të studentëve. Ato u vihen në dispozicion studentëve sipas rregullave administrative në çdo rast që kërkohen prej tyre edhe pas përfundimit të studimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.	Zyra e Burimeve Njerëzore (ZBNj) mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e stafit të angazhuar mbi bazën e procedurave ligjore dhe atyre rregullatore në institucion. Të dhënat përmbajnë përshkrime të detajuara të dosjes personale për secilin anëtar të stafit akademik, personelit ndihmës shkencor dhe administrativ. Databaza me të dhëna në sistemin EIS përditësohet në vazhdimësi në bazë të informacionit të paraqitur nga çdo anëtar i personelit para fillimit të punësimit të tyre si një personel me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, si dhe informacioneve që mblidhen/përpunohen nga departamenti.

<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ verifikoi praktika të rekrutimit të personelit, të cilat ishin në përmbushje të kriterëve ligjore dhe të akteve rregullatore në institucion.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriterëve të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit janë parashikuar në Rregulloren e Universitetit dhe bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterëve të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Praktika e rekrutimit të personelit bazohet në nevojat e institucionit, standardet ligjore dhe rregullatore dhe synon të përzgjedhë kandidatë me cilësi profesionale. Ato sigurojnë një proces të drejtë vlerësimi, përzgjedhja lidhet me specifikat e kriterëve, kërkesave, nevojave dhe ofertave konkurruese. Thirrja është online dhe e hapur për individët që kanë cilësitë për konkurrim.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëcente dhe efektive</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>




<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Në përputhje me rregulloret e brendshme dhe legjislacionin në fuqi institucioni siguron kushtet e nevojshme të punës dhe mundësi të përshtatshme për të gjithë personelin. Kjo u konfirmua nga biseda me stafin akademik të cilët ishin të motivuar dhe kishin vite që vazhdonin veprimtarinë në këtë institucion.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Institucioni organizon trajnime dhe mbështet kualifikimin e vazhdueshëm për stafin akademik. Stafi inkurajohet të marrë pjesë në projektet e ndryshme shkëmbimore, në konferenca, dhe në aktivitete të tjera në funksion të rritjes së tyre profesionale, sikurse konfirmohet nga CV e tyre dhe biseda me ta.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Institucioni aplikon forma bashkëkohore të mësimdhënies, asiston dhe mbështet nismat për metodat inovative nga stafi akademik si dhe bazuar në Strategjinë e Universitetit 2018-2022 është investuar në prioritetet strategjike (mësimdhënie, hulumtim, shërbim ndaj komunitetit). Pjesë e masave është edhe trajnimi akademik për Edukimin Dixhital.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni i ka përdorur të gjitha burimet e veta njerëzore në funksion të realizimit të objektivave të programit të studimit. Stafi i kualifikuar shqiptar dhe i huaj është i angazhuar në mësimdhënie, në drejtimin akademik të formimit të studentëve, në realizimin e leksioneve, prezantimeve, projekteve, eseve, provimeve, sikurse dhe në punë administrative për zbatimin me sukses të programit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi IV.3

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Institucioni ofron mjedise të përshtatshme dhe të mjaftueshme për realizimin e të gjithë veprimtarisë mësimdhënëse për studentët e programit të studimeve Bachelor në Shkenca Politike dhe në Marrëdhënie Ndërkombëtare. Në funksion të tyre janë sallat për ligjërata e seminare, sallat e konferencave, laboratorë për lëndë profesionale, laboratorë informatike, një dhomë interneti dhe sallë bibliotekare, të cilat janë më se të mjaftueshme për numrin e vogël të studentëve që ndjekin këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Të gjitha mjediset mësimore janë të pajisura me PC, video-projektorë, rrjet wireless dhe borde smart që mundësojnë zhvillimin e duhur të procesit të mësimin. Zgjerimi i kapaciteteve digjitale në edukimin elektronik dhe kërkimin shkencor është pjesë e strategjisë së Universitetit “EPOKA” që ne e konstatuam përgjatë takimit me stafin akademik, dy prej të cilëve ishin në lidhje me video konferencë, në kushtet që nuk mund të ishin prezentë në Universitet.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në nivel institucional ekzistojnë një numër i mjaftueshëm pajisjes elektronike (kompjuterë, salla laboratorike, biblioteke, etj) për t’u mundësuar studentëve asistimin teknologjik dhe realizimin tërësor të programit mësimor. Për vetë natyrën e programit, elementët teknikë janë mbështetës dhe puna kryesore është e përqendruar në zhvillimin e matjen e dijeve shkencore dhe teorike.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të</p>	<p>Në rang universiteti janë dy laboratorë të pajisur me të gjithë elementët e nevojshëm të teknologjisë së informacionit, të pajisur edhe me programe profesionale mësimdhënie.</p>

pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.				
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Institucioni ofron ambiente të përshtatshme për studentët, me standardet më të larta në sistemin arsimor, duke siguruar një numër të konsiderueshëm ambientesh në mësimdhënie dhe mësimnxënie në dispozicion të studentëve dhe personelit me më shumë se 20 ambiente (klasa, laboratorë, auditoriume, salla konferencash, sallë bibliotekare) të pajisura me sistem ngrohje/ftohjeje, video-projektorë, PC me internet në internet, Smart Boards. Studentët nuk kanë praktika mësimore të detyrueshme, megjithatë ata mbështeten në nismat e tyre kërkimore sipas nevojave.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Standardi IV.4				
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Të gjithë studentët dhe stafi akademik kanë akses të plotë në burimet e bibliotekës mësimore dhe në burimet online bibliotekare sipas marrëveshjeve të nënshkruara nga institucioni. Studentët konfirmuan se mund të shfrytëzojnë literaturën e sugjeruar, element që ka rëndësi për vetë natyrën teorike të programit të studimit.			
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive	Institucioni raportoi se biblioteka ka një numër të konsiderueshëm librash për fusha të ndryshme studimi. Në funksion të programit mësimor në shqyrtim kishte një listë të gjatë titujsh, por sugjerimi i GVJ është pasurimi i kësaj literature me botime më të plota dhe më të reja bashkëkohore, sidomos lidhur me zhvillimet që kanë të bëjnë me Shqipërinë dhe rajonin.			

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.				
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Institucioni ofron akses pa pagesë për botime dhe artikuj shkencorë në biblioteka online sipas marrëveshjes së tij me network të ndryshme, si p.sh, sistemi JSTOR. Çdo anëtar i stafit dhe student mund të ketë akses të pjesshëm ose të plotë në varësi nga marrëveshja në burime të tilla online.			
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka ofron mundësinë e kërkimit të botimeve përmes sistemit të regjistrimit dhe direkt përmes kërkimit faktit në rastet e hapura të renditura sipas librave dhe natyrës së botimeve. Studentët mund të kërkojnë titujt e preferuar përmes sistemit kompjuterik dhe aksesit është i barabartë për të gjithë për ato botime që janë pjesë të bibliotekës.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Institucioni raportoi se koleksioni i bibliotekës është pasuruar me blerje dhe dhurime nga persona të ndryshëm fizikë dhe juridikë. Ai raportoi për rreth 600 tituj specifikë për fushën e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, por nga verifikimi rezultoi se nuk kemi të bëjmë me 600 tituj të ndryshëm por me 600 kopje librash, përfshirë kopje të të njëjtit titull, praktikë e zakonshme për bibliotekat. GVJ vlerëson se pasurimi i bibliotekës me literaturë të re dhe bashkëkohore që lidhet me programin e studimit mbetet një detyrë dhe sfidë për t'u përmbushur nga institucioni.			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka ka orar fleksibël në funksion të studentëve dhe mbetet e hapur për të qenë gjithnjë në funksion të tyre në varësi nga kërkesat dhe ecuria e procesit akademik mësimor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Institucioni ka një sistem të verifikueshëm dhe transparent të administrimit të të gjithë informacioneve që lidhen me studentët, aktivitetin, rezultatet dhe vlerësimin e tyre, raportet e tyre me institucionin nga regjistrimi deri në përfundim të studimeve. Për më tepër institucioni mban lidhje dhe ka të dhëna edhe për studentët pas përfundimit të studimeve, duke dashur të ketë statistika në vazhdimësi lidhur me ndikimet në karrierë, angazhimet në tregun e punës, interesin për kualifikim të mëtejshëm, etj.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Institucioni përmes sistemit EIS dhe zyrave përkatëse administrojnë rregullisht të gjithë informacionin dhe dokumentacionin mbi aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik, stafit administrativ dhe partnerëve.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi EIS mundëson akses të dedikuar për të gjithë studentët dhe stafin akademik lidhur me angazhimin, pjesëmarrjen, datat e provimit, notat e përkohshme dhe notat përfundimtare, kurrikulën e programit, transkriptimin, llogaritjen e notave, programin javor, kërkesat dhe njoftimet.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe	Sistemi EIS mundëson komunikim të rregullt dhe interaktiv midis personelit akademik dhe studentëve, pyetje e përgjigje, kërkesa dhe dhënie informacioni, etj.

shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.				
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Sistemi EIS bën të mundur monitorimin dhe ndjekjen e të gjithë aktivitetit akademik dhe administrativ, raportimet individuale dhe hedhjen e të dhënave. Përmes sistemit, drejtuesit e institucionit mund të marrin informacionet e nevojshme në funksion të programit në kohë reale. Sistemi ofron, jo vetëm monitorimin e veprimtarisë akademike, por edhe informacionet mbi kurset, syllabuset, aktivitetet, bursat, të dhënat financiare dhe administrative, prezencën dhe përmeshjen e detyrimeve programore.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Institucioni dhe në veçanti departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare publikon rregullisht në faqen e internetit, të dhëna të plota mbi programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet, botimet kryesore, thirrjet për projekte, etj. Njoftimet janë në dy gjuhë, shqip dhe anglisht.			
Shkalla e përmeshjes së standardit	Nuk përmeshet	Përmeshet pjesërisht	Përmeshet kryesisht	Përmeshet plotësisht
				X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të	Institucioni harton rregullisht raporte financiare mbi kostot e programeve të studimit, përfshirë edhe programin në shqyrtim. Raporti përfshin edhe planet për mbështetjen e nevojshme financiare për programin. Raporti dhe plani financiar kalon në të gjitha strukturat bazë dhe drejtuese deri në miratimin nga Bordi i Administrimit i Universitetit “EPOKA”.

studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Plani financiar i institucionit, bazuar në Statutin e Universitetit, përmban financimin e rregullt të burimeve njerëzore, shpenzimet operative dhe administrative, shpenzimet për bibliotekën dhe detyrimet e tjera financiare në funksion të realizimit të plotë të programit të studimit. Të ardhurat bazohen kryesisht nga tarifat e studentëve dhe fondet kërkimore shtesë kombëtare ose ndërkombëtare. Plani financiar miratohet nga Bordi i Administrimit edhe është publik për të gjithë stafin dhe studentët.</p> <p>Institucioni aplikon auditimin nga Turgut Ozal Education sh.a., ent në marrëveshje me universitetin. Raportet e auditimit depozitohen në institucion si dhe bëhen të njohura për organet drejtuese sipas praktikave të brendshme funksionale.</p> <p>Raporti përmban të gjitha analizat e të dhënave mbi shpenzimet dhe të ardhurat e Universitetit dhe institucioneve të përfshira, të gjitha hyrjet që lidhen me të ardhurat (grante, studentë; tarifa) dhe të gjitha shpenzimet për shërbimet që ai ofron drejtpërdrejt ose indirekt (nga ndërmarrjet e jashtme). I njëjti raport auditimi aplikohet edhe për programet e studimit, përfshirë programin në shqyrtim nga GVJ.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Institucioni harton, zhvillon dhe trajton raportet financiare dhe të auditimit, mbi bazën e të cilave bën analiza dhe projekte ndërhyrjeje ose përmirësuese në varësi nga qëllimet, synimet dhe kapacitetet e institucionit, si dhe realizimit të detyrimeve të plota të programeve të studimit.</p> <p>Nga të dhënat institucionale të konfirmuara nga ASCAL përmes akreditimit institucional, universiteti garanton qëndrueshmëri financiare përgjatë viteve të programit në shqyrtim si dhe studimeve të thelluara në nivel Master dhe Doktoraturë.</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare</p>	

për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.				
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni ka politika të qarta lidhur me të gjithë ciklin e studimeve dhe për të gjithë vitin akademik, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ai ka procedura, politika dhe mekanizma që mbulojnë ciklin e plotë akademik si dhe ka akte rregullatore në nivel institucioni, në nivel dekanati, në nivel njësie bazë dhe në nivel programi të studimit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Praktika e regjistrimit të studentëve dhe e aktivitetit të tyre mësimor deri në përfundim të studimeve, ashtu si edhe ajo e transferimit të studimeve, ndërprerjeve apo aktiviteteve të tjera me interes studentor, janë të përcaktuara me aktet e brendshme rregullatore dhe sigurojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Të gjitha procedurat dhe kriteret që lidhen me pranimin e studentëve, përzgjedhjen e tyre, formën e testimit për pranim, ecurinë gjatë programit të studimit, rastet e transferimit apo të njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe të studimeve deri në diplomim, bëjnë pjesë në paketën e informacioneve të aksesueshme për çdo student dhe që bëhet e njohur që në fazën e regjistrimit në universitet. Ato reflektojnë legjislacionin në fuqi mbi arsimin e lartë dhe dokumentet rregullatore të institucionit. Të gjitha dokumentet janë publike.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Në përputhje me legjislacionin mbi arsimin e lartë në Shqipëri dhe politikat strategjike institucioni publikon përpara çdo viti akademik kriteret preferenciale lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve për ciklin e parë të studimeve. Dokumentet dhe kriteret përkatëse janë publike.</p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Institucioni vepron mbi bazën e vendimmarrjeve ligjore të MASR dhe udhëzimeve të saj përkatëse për pranimet në universitete. Në institucion pranohen në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë studentë vendas dhe të huaj që plotësojnë kriteret e pranimit dhe ndjekin procedurën ligjore të regjistrimit. Aktualisht ka studentë të huaj edhe në programin në shqyrtim nga GVJ.</p>
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të</p>	<p>Institucioni përmes Zyrës së Pranimit të Studentëve organizon Programin e Planifikimit të Karrierës për studentë të mundshëm. Në programin e përmendur, studentët e</p>

interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	interesuar janë të ftuar në kampusin “EPOKA”, ku ata mund të marrin informacion të detajuar për Universitetin në përgjithësi dhe programet specifike të studimit për të cilat interesohen. Gjithashtu të gjithë dokumentet informative gjenden online për personat e interesuar. Studentët në bisedat me GVJ konfirmuan se ata ishin të informuar për gjithçka lidhur me studimet përpara se të nisnin programin Bachelor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Bazuar në Rregulloren e institucionit dhe në atë për ciklin e parë të studimeve institucioni jep informacione të plota mbi kriteret dhe procedurat për përparimin akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin. Sipas kriterëve studentët duhet të kalojnë të gjitha lëndët në program në mënyrë që të plotësojnë të gjitha kushtet e programit të studimit.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Bazuar në aktet rregullatore të institucionit studentët informohen lidhur me procedurat dhe parimet e njohjes së kualifikimeve të mëparshme të plota ose të pjesshme të studimeve universitare. Kjo kishte mundur që mjaft studentë të transferoheshin nga universitete të tjera nga jashtë vendit dhe anasjelltas. Dokumentet e mësipërme informuese janë publike.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Institucioni organizon pritjen dhe informimin fillestar të studentëve mbi të gjitha elementët që lidhen me procedurat dhe kriteret e vlerësimit të dijeve dhe të aftësive, përmbajtjen e programit dhe problematika të ndryshme me interes studentor gjatë vitit akademik. “Udhëzuesi smart i studentëve” jep informacione të detajuara

Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Institucioni informon rregullisht studentët me kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe procesin e diplomimit. Informimi nis që në fazën e pranimit dhe vijon edhe gjatë cikleve të studimit në varësi nga interesi studentor.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Institucioni përmes Zyrës së Pranimit të Studentëve organizon Programin e Planifikimit të Karrierës për maturantët e shkollave të mesme. Gjithashtu në pritjen e kandidatëve për studentë në ciklin e parë të studimeve institucioni ofron informacione të detajuara për universitetin dhe programet e studimit. Studentët pajisen me broshurë informative dhe gjatë gjithë periudhës së studimeve ata mund të marrin informacione të tjera shtesë në funksion të tyre dhe të programit. Informacionet janë publike në faqen zyrtare të institucionit dhe në formë broshure print.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Nëpërmjet paketës informative institucioni informon me hollësi studentët për të gjithë elementët e strukturës, organizimit, kohëzgjatjes së studimeve dhe informacione të tjera me interes për ta në të gjithë ciklin të parë të studimeve. Studentëve iu jepet informacion i detajuar mbi programin mësimor, lëndët, stafin akademik dhe praktikatat e vlerësimit të dijeve.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të	Institucioni dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit u vë në dispozicion studentëve informacion dhe dokumentacion udhëzues të detajuar mbi modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtarinë formuese. Stafi akademik dhe ai ndihmës administrativ, sikurse u shprehën studentët, ishte

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	shumë i disponueshëm për çdo informacion të kërkuar nga studentët.			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Institucioni, përmes zyrës së Këshillimit të Karrierës, informon rregullisht studentët mbi studimet mbi tregun e punës, mbi mundësitë e punësimit, mbi përputhshmërinë e moduleve me trendin e punësimit, si dhe ka databazë me të dhëna për studentët e diplomuar dhe punësimin e tyre.			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Institucioni, përmes sistemit online, broshurave, seancave informuese, takimeve orientuese, etj, informon studentët në mënyrë të kënaqshme mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikës, infrastrukturës dhe shërbimeve të ofruara nga njësitë administrative dhe Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare.			
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Përmes sistemit interaktiv online EIS institucioni realizon informimin e vazhdueshëm për studentët edhe në rastet e distancës, përfshirë edhe periudhën e COVID-19. Studentët në profilin e tyre mund të përdorin informacionin e tyre personal dhe informacionin në lidhje me programin e tyre të studimit, për programimin e angazhimit të tyre dhe për ndryshime dhe informacione me vlerë në studimet e tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të	Institucioni, përmes Sekretarisë Mësimore ka informacion të detajuar dhe raporton mbi numrin e studentëve dhe të të diplomuarve gjatë vitit akademik dhe gjatë viteve të tjera në

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>programin e studimit. Të dhënat depozitohen sipas legjislacionit në fuqi edhe në MASR. GVJ verifikoi statistikat vjetore për vitet akademike 2018-2019, 2019-2020 për numrin e studentëve aktual dhe të diplomuar në programin e studimit në shqyrtim dhe i gjeti ato korrekte.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Institucioni ka statistika vjetore me të dhëna të detajuara për çdo student, përfshirë numrin e tyre, rastet e angazhimit në programe shkëmbimore, të tërheqjes nga programi, të ndërprerjes së përkohshme ose të përhershme të studimeve, të largimit nga programi apo e të diplomuarve nga programi. Databaza është transparente dhe e njëjtë me të dhënat e depozituara periodikisht në MASR.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Institucioni ka të dhëna të detajuara dhe statistikore për ecurinë e studentëve gjatë gjithë programit mësimor, sikurse u konstatua gjatë shqyrtimit të rregjistrave në sekretarinë mësimore.</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Institucioni përmes sistemit EIS siguron hedhjen dhe ruajtjen e të dhënave, menaxhimin e brendshëm të informacionit mbi studentët, si dhe mundësinë e monitorimit dhe verifikimit nga individët e autorizuar. Nuk ka pasur raste të raportuara të shkeljes së elementëve të sigurisë mbi këto të dhëna në tre vitet e studimit të programit në vlerësim.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të</p>	<p>Institucioni përmes Zyra e Pranimit të Studentëve dhe Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentët e Diplomuar harton raporte vjetore periodike për prurjet e reja studentore, për ecurinë e studentëve gjatë procesit mësimor si dhe për studentët e diplomuar. Të dhënat janë përdorur edhe për qëllime studimore mbi arritjet, problematikat, por edhe ndjekjen e angazhimit të tyre pas diplomimit në studime të avancuara ose në tregun e punës. Sipas të dhënave të institucionit, rreth 68% e studentëve të diplomuar pjesë e</p>

përmirësimit të këtyre treguesve.	programit Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare janë të punësuar, 18% po vazhdojnë studimet e tyre Master, 7% janë të papunë dhe 13% nuk kanë mbyllur studimin, - të dhëna që GVJ nuk mund t'i konfirmojë dhe as t'i vërë në dyshim – por që konfirmon analizën e situatës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Bazuar në dispozitat ligjore mbi arsimin e lartë, udhëzimet e MASR, si dhe aktet rregullatore në universitet, studentët kanë rol dhe përfaqësim në procesin vendimmarrës në organet këshillimore dhe vendimmarrëse të institucionit. Në dallim nga universitetet publike në institucione të arsimit privat, ku bën pjesë edhe institucioni në shqyrtim, rektori, dekani dhe përgjegjësi i departamentit nuk zgjidhen me votim, ndaj edhe studentët nuk kanë të drejtë vote sipas ligjit. Megjithatë ata kanë kuota të rregullta përfaqësimi në të gjitha strukturat vendimmarrëse, kontrolluese, monitoruese dhe këshillimore të institucionit.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Studentët, bazuar në aktet rregullatore të institucionit, janë të përfaqësuar rregullisht në organet vendimmarrëse siç janë: Senati Akademik; Bordi i Etikës; Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë; dhe Komisioni i Përhershëm për Marrëdhëniet Studentore. Ata janë pjesë e konsultimeve të vazhdueshme, e ndikimit përmes anketimeve dhe me mundësi ndikimi me sugjerime edhe në përmirësime të punës apo vendimmarrjes në të gjitha nivelet, duke filluar që nga njësia bazë.

<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Institucioni, bazuar në dokumentacionin e brendshëm, mban parasysh ngarkesën akademike të studentëve gjatë procesit të hartimit dhe përmirësimit të programeve. Gjithashtu ai mban parasysh edhe elementët e transparencës në progresin e studentëve gjatë jetësimit të programit, përfshirë zgjidhjen e arsyeshme të rasteve të njohjes së studimeve të plota ose të pjesshme të mëparshme. Ngarkesa akademike në program është 30 ECTS për semestër. Kreditë minimale evropiane për një lëndë janë 5 ECTS dhe maksimumi 6 ECTS. Studentët nuk patën shqetësim lidhur me ngarkesën, por lidhur me kohën e zhvillimit të studimeve, duke kërkuar evitim të orareve të pasdites së vonë me ndërprerje të gjatë kohore nga oraret e paradites.</p> <p>Në rastin e aplikimeve për transferim nga universitete të tjera aplikohen kushtet e përcaktuara nga MASR.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Studentët, përmes anketimit dhe formave të tjera konsultative, por edhe përmes përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarëse, bazuar në dokumentin "Për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit" marrin pjesë në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Opinioni i tyre merret në konsideratë, fakt që u konfirmua edhe nga takimi i GVJ me studentët.</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Bazuar në politikat dhe aktet rregullatore të institucionit studentët jo vetëm përmes përfaqësuesve të tyre në Senat, KPSC etj, por edhe përmes vlerësimit të lëndëve dhe të mësimdhënies, mund të ndikojnë në forcimin e komponentëve të barazisë, sigurisë dhe ndershmërisë në vlerësimin e dijeve. Institucioni parashikon mekanizma ankimimi dhe procedura të adresimit dhe vendimmarrjeve transparente ndaj tyre. Funkcioni i këshilltarit akademik (brenda departamentit) ndihmon në jetësimin e këtyre të drejtave dhe praktikave.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.6	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Institucioni ka funksionale Zyrën e Koordinimit të Studentëve si mekanizëm në shërbim të informimit të vazhdueshëm dhe për pranimin e kërkesat e studentëve. Gjithashtu, në zbatim të legjislacionit, janë parashikuar në detaje procedurat e ndjekjes së kërkesave, të drejtat studentore dhe mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Përmes "Udhëzuesin smart të studentëve", Zyrës së Karrierës dhe mekanizmave të tjerë rregullatorë, institucioni mban një sistem të posaçëm informimi, këshillimi dhe ndjekjeje të progresit të studentëve.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Institucioni përmes Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Studentët e Diplomuar ofron informacion dhe asistencë për këshillimin në karrierë. Të dhënat janë të vazhdueshme duke u siguruar studentëve informacionin e nevojshëm që mund t'i ndihmojë ata në karrierën e tyre të ardhshme, mundësitë për trajnime dhe pjesëmarrje profesionale në aktivitete me biznesin, orientim për praktika dhe mbështetje për të gjitha fazat e tjera të procesit mësimor. Institucioni u vë në dispozicion studentëve studimet e tregut si dhe informacion mbi marrëveshjet e partneritetit dhe mundësitë e angazhimeve në kuadër programor dhe institucional.

Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentët e Diplomuar gjurmon studentët pas diplomimit, mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave për llojin dhe cilësinë e punësimit të programit të studimit dhe vënien e tyre në dispozicion të studentëve, organeve përkatëse dhe autoriteteve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Institucioni, në zbatim të legjislationit në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore, ka politika, struktura dhe procedura të përhershme të sigurimit të cilësisë. Organi kryesor është Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC), me njësitë e vogla përbërëse të tij, si Zyra e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Bordi i Provimeve, të cilat përbëjnë sistemin e brendshëm të Sigurimit të Cilësisë të Universitetit “EPOKA”. Të drejtat, përbërja, kompetencat dhe aktet procedurale të vendimeve janë të përcaktuara në Statut dhe në aktet e tjera rregullatore të institucionit.

<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni ka ngritur Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC), i cili është organ përgjegjës për sistemin e brendshëm të Sigurimit të Cilësisë së Universitetit “EPOKA”. KPSC zbaton strategjinë institucionale për monitorim, kontroll, raportim dhe përmirësim të vazhdueshëm. Në aktivitetin e tij përfshihen edhe studentët, si dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. Studenti anëtar i Grupit të Vlerësimit të Brendshëm ishte prezent në takimet në Universitetin “Epoka”.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Institucioni, bazuar në detyrimet dhe përcaktimet ligjore dhe standardet e mira ka siguruar instrumentet e nevojshme për sigurimin e cilësisë, për procesin e vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimet analitike dhe procese plotësuese që promovojnë cilësinë. Këto instrumente nga vizita në institucion rezultojnë që nga pyetësorët e standartizuar periodikë me studentët në përfundim të çdo semetri dhe lënde, deri tek vlerësimet periodike të performancës së stafit akademik dhe promovimi i tyre i vazhdueshëm.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Institucioni ka hartuar dokumentin për "Politikën e Cilësisë", "Për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit" si dhe "Manuali i Sigurimit të Cilësisë" për të siguruar dhe përmirësuar cilësinë e programeve të studimit, si dhe për të krijuar një kulturë të rritjes së cilësisë në nivelin institucional, njësitë përbërëse dhe të gjithë aktorët e brendshëm institucionalë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.2

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Në nivel institucioni dhe njësie bazë janë ngritur strukturat e posaçme për monitorimin e cilësisë së programeve mësimore. GVJ konfirmon se monitorimi dhe rishikimi i programit të studimit në shqyrtim kryhet nga departamenti përkatës në përputhje me politikën e institucionit "Për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit". Në këtë proces përfshihet edhe Komisionit të Zhvillimit të Kurrikulave si një njësi nën Komisionin e Përherëshëm për Sigurimin e Cilësisë në Universitetin "EPOKA".</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Procesi i shqyrtimit, miratimit dhe monitorimit të vazhdueshëm të programeve të studimit realizohet përmes formave të ndryshme, përfshirë anketimi, analiza, ekspertiza e brendshme dhe e jashtme.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Raportet e departamentit ku aplikohet programi i studimit dhe rezultatet e "Studimit të Vlerësimit të Instrukturëve të lëndës " janë burimi më i rëndësishëm i informacionit mbi vlerësimin e cilësisë së mësimin. Rezultatet, bazuar në reagimet e studentëve për secilën lëndë të ofruar gjatë semestrit, përbëjnë një element thelbësor për përparimin dhe suksesin e programit të studimit. Në të njëjtën kohë, departamenti përgatit raporte analitike, bazuar në vizitat në klasa gjatë orës së mësimin të titullarit, stafi akademik pranon dhe shqyrton ankesat dhe sugjerimet, ndërkohë që Bordi i Provimeve bën vlerësimin e cilësisë së provimeve.</p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Departamenti plotëson bazën e të dhënave të vlerësimit për programin e studimit. Mbledhja e të dhënave për përgatitjen e raporteve vjetore dhe raporteve të vlerësimit të brendshëm bëhet përmes koordinimit të Zyrës së Rektorit dhe Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Përmes realizimit të anketës me studentët rezultatet e saj paraqiten në sistemin</p>

	EIS. Të gjitha aktet e vlerësimit i bëhen të njohura drejtuesve të departamentit dhe të fakultetit, dhe në raste të veçanta, sipas problematikës, edhe autoriteteve më të larta të institucionit.			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Bazuar në procedurën e institucionit, raportet e vlerësimit përfshijnë krahas të dhënave dhe konstatimeve mbi situatën aktuale të evidentuar, edhe prognoza mbi rezultatet e pritshme, vlerësimin për masat e marra dhe adresimin konkret të mangësive dhe sugjerimeve, si dhe ndjekjen e fazave të jetësimit të tyre në funksion të rritjes së vazhdueshme të cilësisë. Raportet e vlerësimit të brendshëm të përgatitur në kuadër të akreditimit të programeve të studimit dhe planeve të veprimit për të ndjekur rekomandimet e mbetura nga akreditimi i mëparshëm, përdoren për përparimin e programit të studimit			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Institucioni, bazuar në procedurat e brendshme dhe kërkesat ligjore, bën të mundur vlerësimin periodik të cilësisë nga departamenti dhe Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë për çdo program studimi, përfshirë programin në shqyrtim. Të gjitha gjetjet dhe të dhënat, konstatimet dhe rekomandimet për përmirësim janë pjesë e paketës informative që institucioni trajton në kuadër të vetëvlerësimit institucional, të akreditimit dhe të vlerësimeve të brendshme periodike.

<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Në funksion të vlerësimit sa më profesional institucioni përdor metoda dhe instrumente të ndryshme, përfshirë anketime, debate të brendshme, raporte monitorimi dhe analize, pjesëmarrje e monitorim të proceseve mësimdhënëse dhe të provimeve, angazhimin e ekspertizës së jashtme, etj. Përzgjedhja e tyre bëhet mbi bazën e natyrës së programit, veçorive të tij si dhe prioriteteve strategjike të institucionit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Institucioni ka funksionale mekanizma si Bordet e Provimeve, anketimin për formën e vlerësimit të provimeve, instrumente të përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit, etj, të cilat plotësojnë kuadrin e përgjithshëm të kontrollit të cilësisë dhe analizës së brendshme të programit. Në funksion të gjetjeve praktike institucioni përdor forma klasike dhe bashkëkohore, siç janë anketimet, vlerësimi për programin dhe syllabuset, pjesëmarrja monitoruese në mësimdhënie, pranimi i ankesave, debati i përbashkët mbi problematika të programit, intervista, etj, si dhe raporte të analizës krahasuese të rezultateve dhe pritshmërive. Të gjithë elementët e cituar në kriterin 3 janë pjesë e këtyre praktikave.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e</p>	<p>Në funksion të cilësisë, kontrollit të brendshëm dhe synimeve të programit mësimor institucioni përdor forma të ndryshme anketimesh (Anketimi i Kënaqësisë së Studentit", "Anketimi i Studentëve të Diplomuar", "Anketimi i Kënaqësisë së Kompanisë", etj), kryen studime mbi aspekte të ndryshme të programit, bën anketime të vlerësimit të Instruktorëve të lëndës, merret mendimi i studentëve online mbi 14 pyetje mbi përmbajtjen e lëndës, metodat e mësimdhënies, performancën e pedagogut të lëndës, komentet dhe rekomandimet e studentëve, etj. Bazuar në</p>

administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Rezultatet e Anketës së Vlerësimit departamentet përkatëse përgatisin raporte të cilat i dorëzohen Dekanatit. Po ashtu, këshilltari akademik (personel akademik me kohë të plotë nga departamenti) merr reagimin e studentëve për çështje të ndryshme në lidhje me programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni ka një sistem vlerësimi të brendshëm efektiv, përmes të cilit kontrollon cilësinë dhe garanton standardet e saj në të gjithë etapat e aktivitetit, përfshirë edhe në programin në shqyrtim nga GVJ. Kompetencat e përgjegjësitë janë të përcaktuara në Statutin e Universitetit. Senati krijon Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) për të garantuar cilësinë institucionale dhe të programeve të studimit, si organ përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Komisioni përbëhet nga të paktën tetë anëtarë, ata zgjidhen nga Senati Akademik, për një periudhë dy vjeçare, me të drejtë riemërimi. Institucioni garanton edhe procedurat e brendshme të ushtrimit të kontrollit të cilësisë dhe mekanizmat e vlerësimit të gjetjeve.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë	Në nivel institucioni Senati është organi përgjegjës për mirëfunksionimin, si dhe sigurimin e cilësisë së brendshme. Senati Akademik ka krijuar Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë për të garantuar cilësinë e programeve institucionale dhe të studimit. Statuti i institucionit ka

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>përcaktuar qartësisht përgjegjësitë, detyrat konkret, pjesëmarrjen e studentëve si palë, etj, në të gjitha fazat e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në nivel të programit, departamenti është organi përgjegjës për mirëfunksionimin, si dhe sigurimin e cilësisë së brendshme në përputhje me standardet shtetërore. Në nivel institucional Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë përfaqëson mekanizmin përgjegjës. Ai përbëhet nga së paku një anëtar i stafit akademik me kohë të plotë në njësinë kryesore me të paktën gradën shkencore "Doktor", nga të paktën dy anëtarë të personelit administrativ, një përfaqësues i të diplomuarve të Universitetit, si dhe një specialist i jashtëm me një përvojë të gjerë në çështje të sigurimit të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Procedurat e përcaktuara nga Statuti i institucionit, vendimmarrja e Senatit Akademik, si dhe aktet e tjera rregullatore ofrojnë garanci për përfshirje të gjerë të një numri të madh aktorësh në procedurat periodike të vlerësimit të brendshëm dhe të cilësisë, si dhe për shmangien e çdo lloj diskriminimi ndaj personelit apo ndaj studentëve. Funkcionet dhe përbërja e Senatit Akademik dhe Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, provojnë se institucioni rregullon dhe garanton përfshirjen e aktorëve të brendshëm në procedurat e vlerësimit të vazhdueshëm duke respektuar integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi ose pabarazie ndaj personelit dhe studentëve.</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Senati Akademik zgjedh Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, ku në përbërje të tij është edhe një specialist i jashtëm me një përvojë të gjatë në çështje të sigurimit të cilësisë. Kjo formë e përfshirjes së ekspertizës së jashtme ka qenë funksionale sipas raporteve të Komisionit.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat, strategjia, organizimi dhe aktivitetet brenda kornizës së sistemit të Sigurimit të Cilësisë së brendshme janë publike online http://aeqi.epoka.edu.al/cat-qa-documents1404.html) dhe në faqen kryesore të Universitetit "EPOKA" (http://epoka.edu.al/home-personelf-doc-publications-6-404.html). Stafi akademik, studentët, prindërit dhe partnerët mund të kenë akses të vazhdueshëm online në përmbajtjen dhe raportet e vlerësimit. Institucioni u vë në dispozicion të gjithë studentëve "Udhëzuesin e smart të studentëve" me informacionet më të nevojshme cilësore dhe administrative në interes të tyre.
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit të programeve të studimit, duke respektuar kërkesat ligjore në fuqi. Në respekt të të drejtave dhe të dhënave personale institucioni ka organizuar edhe trajnime për personelin akademik dhe administrativ për "Mbrojtjen e të dhënave" në bashkëpunim me Komisionerin për Informacionin dhe Mbrojtjen e të Dhënave.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Institucioni, sipas detyrimeve statusore dhe në Rregullore, të gjitha gjetjet që vijnë nga mekanizmat e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm, i trajton në organet drejtuese në varësi nga problematika, për t'u dhënë zgjidhje optimale. Ai operon me një Plan Veprim të miratuar nga Senati, ndërkohë që secili institucion në hierarki (njësitë administrative dhe akademike), hartojnë dhe zbatojnë plan veprimin e tyre të brendshëm. Dekani dhe përgjegjësi i Departamentit gjatë bisedës me ta në institucion na qartësuan veprimtaritë e ndërmarra për adresimin e dobësive të evidentuara sipas

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	dokumentitno. 75, datë 21.09.2017 “The Action Plan of Political Science and International Relations Department in Response to the Recommendations from ASCAL Review”, miratuar nga Senati i Universitetit në 6 Nentor 2019.			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Politikat dhe Procedurat e Sigurimit të Cilësisë i nënshtrohen një procesi zyrtar të miratimit, janë plotësisht të dokumentuara dhe janë rishikuar dhe zhvilluar si përgjigje ndaj ndryshimeve, nevojave dhe kërkesave të kohës dhe legjislacionit. Staf i akademik ishte i ndjeshëm dhe i motivuar për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit duke investuar në zhvillimin e aftësive të tyre profesionale akademike.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Të gjithë studentët e vitit të parë marrin informacion nga NJSCB mbi sistemin e sigurisë, praktikave të vetëvlerësimit, monitorimit, etj, në funksion të përfshirjes së tyre, transparencës dhe kontributit të pritshëm në rritjen e cilësisë së programit të studimit. Kjo u konfirmua gjatë bisedës me stafin akademik dhe studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor
“Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare” i
Institucionit të Arsimit të Lartë “UNIVERSITETI EPOKA”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Kapacitetet institucionale me standarde të larta referuar burimeve njerëzore, infrastrukturës, etj., për mbarëvajtjen e programit të studimit në të gjitha fazat e studimeve të ciklit të parë Bachelor.
2. Prurje studentore cilësore, të qëndrueshme në kohë që tregon se studentët janë të kënaqur me studimet në Universitetin “Epoka”, pasi referenca e shumicës prej tyre kanë qenë studentët e diplomuar më parë nga ky universitet.
3. Programi siguron standardet e mësimdhënies cilësore, përmirësimit të vazhdueshëm, transparencës në informimin e studentëve, të dhënat për provimet finale dhe përmbajtjen e syllabuseve, promovon idetë novatore dhe nxitjen e studentëve dhe të stafit akademik për zgjerim të njohurive profesionale dhe siguron një sistem transparent të vlerësimit të dijeve.
4. Stafit akademik dhe administrativ synon të ndjekë standarde cilësore në drejtim të jetësimit të programit të studimit.
5. Institucioni zotëron mjedise të mjaftueshme dhe ka infrastrukturën e duhur për ushtrimin e plotë të komponentëve akademikë të mësimdhënies gjatë gjithë aktiviteteve të vitit akademik.
6. Institucioni ofron komoditetet në asetet teknologjike, laboratorët, mjediset e konferencave, në funksion edhe të këtij programi studimi.
7. Në funksion të studentëve dhe stafit është biblioteka e institucionit dhe abonimi në burimet online të botimeve dhe artikujve shkencorë bashkëkohorë.
8. Zhvillimi i mësimin në anglisht tërheq studentë dhe staf akademik cilësorë.
9. Harmonizimi i stafit akademik shqiptar dhe të huaj, mbështetja e avancimit akademik të tyre si dhe metodika e avancuar e përdorur prej tyre në dhënien dhe matjen e dijeve të studentëve, nxitjen e tyre për mendim kritik, si dhe përgatitjen e tyre konkurruese në raport me modelet perëndimore.
10. Numri i madh i marrëveshjeve të bashkëpunimit, sistemi i shkëmbimeve studentore, pjesëmarrja në aktivitete të formimit shkencor, si dhe lidhja me tregun e punës
11. Të dhënat në databazë të institucionit mbi studentët, programet, ecurinë e studimeve dhe post studimeve, analizat profesionale dhe sistemi i integruar online i të dhënave e dokumentacionit në institucion.
12. Struktura solide të garantimit të Cilësisë, orientimit të studentëve dhe ndjekjes së karrierës së tyre edhe pas studimeve në Universitetin “EPOKA”.
13. Dokumentacion i saktë, i plotë dhe një staf i përgjegjshëm akademik dhe administrativ.



Pika të dobëta:

1. Mungesa e rakordancave midis raportit të RVB dhe të dhënave reale të institucionit në lidhje me stafin akademik, si dhe përdorimi i të dhënave të institucionit në RVB si të dhëna edhe për programin e studimit në shqyrtim.
2. Në programin mësimor ka mospërputhje të orëve në auditor për lëndët 45/48 dhe 60/64 si dhe përcaktimin e orëve vetëm të leksioneve (teorike) me zero orë seminare dhe praktika.
3. Referuar shqetësimeve studentore për orarin e zgjatur të mësimit (paradite-pasdite) dhe për mungesën e periudhës së mesme përgatitore midis provimeve (ka raste dy provime në një ditë).

Rekomandime:

1. GVJ rekomandon rishikimin e dokumenteve rregullatorë si institucion jopublik me legjislacionin mbi arsimin e lartë (zgjedhjet, emërimet, mandate, etj)
2. Koncepti i studimit të tregut është i fokusuar brenda vendit, kurse studentët shprehën interes për tregun jashtë vendit. GVJ rekomandon për harmonizim më të madh të studimeve të tregut me përmbajtjen e programit mësimor dhe pritshmëritë e studentëve.
3. GVJ rekomandon përmirësim dhe harmonizim i vazhdueshëm i dokumentacionit të programit, saktësimin në programin mësimor në përcaktimin e orëve të mësimit, të cilat herë dalin 45/60 herë 48/64 orë në auditor. Gjithashtu, GVJ rekomandon që programi mësimor të ketë ndërthurje të orëve teorike të leksioneve me orë seminaresh e praktikash profesionale. Lëndët janë përcaktuar në mënyrë të njëjtë me 5 ECTS, me përjashtim të semestrit të gjashtë ku ka 5 lëndë me 6 ECTS secila prej tyre. Këtu ka vend për rishikime.
4. GVJ rekomandon që tekstet fizike në bibliotekë të pasurohen vazhdimisht me botime profesionale të viteve të fundit që lidhen me zhvillimet politike në Shqipëri e rajon, si dhe abonime në revistat shkencore që ekzistojnë në Shqipëri.
5. Standardi III.7/ Kriteri 2, lëndët e gjuhëve të huaja (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe turqisht) dominojnë në program. GVJ rekomandon që krahas tyre studentët do ishte mirë të marrin edhe njohuri në fushën e teknologjisë së informacionit, të cilën mund ta aplikojnë lehtësisht në dy sallat moderne të laboratorëve me kompjuterë. Gjithsesi studentët në lëndën e Metodave Kërkimore që zhvillohet në Semestrin e tretë marrin njohuri për dy software, SPSS dhe Nvivo, me qëllim hedhjen dhe përpunimin e të dhënave të marra nga përdorimi i metodave të kërkimit sasior.



Conclusions of the Evaluation of the first cycle Bachelor study program
"Political Science and International Relations" of the
Higher Education Institution "EPOKA UNIVERSITY"

Strengths and affirmations:

1. Institutional capacities with high standards referring to human resources, infrastructure, etc., are an important factor for the progress of the study program of the first cycle Bachelor studies.
2. Quality students' stream, stable in time that shows that students are satisfied with studies at the University "Epoka", as the reference of most of them have been students previously graduated from this university.
3. The program ensures standards of quality teaching, continuous improvement, transparency in student information, final exam data and syllabus content, promotes innovative ideas and encourages students and academic staff to expand professional knowledge and provides a transparent system of knowledge assessment.
4. Academic and administrative staff aims to follow quality standards in terms of implementation of the study program.
5. The institution owns sufficient facilities and has the necessary infrastructure for the full exercise of the academic components of teaching during all activities of the academic year.
6. The institution offers amenities in technological assets, laboratories, conference facilities, in function of this study program.
7. For the benefit of students and academic staff is the library of the institution and subscription to online sources of contemporary scientific publications and articles.
8. The development of teaching in English language attracts quality students and academic staff.
9. Harmonization of the Albanian and foreign academic staff, support of their academic advancement as well as the advanced methodology used by them in teaching and measuring the knowledge of students, encouraging them for critical thinking, as well as their competitive preparation in the report with advanced western models.
10. Large number of cooperation agreements, student exchange system, participation in scientific training activities, as well as connection with the labor market.
11. Data in the institution database on students, programs, progress of studies and post-studies, professional analysis and integrated online system of data and documentation in the institution.
12. Solid Unit of Quality Assurance, orientation of students and pursuit of their career even after studies at the University "EPOKA".
13. Accurate, complete documentation and a responsible academic and administrative staff.



Weaknesses:

1. Lack of correlations between the Internal Evaluation Report data and the data of the institution in relation to the academic staff.
2. In the curriculum there is a discrepancy between the hours in the auditorium for subjects 45/48 and 60/64 as well as the in the program structure are defined only hours of lectures (theoretical) with zero hours of seminars and internships /professional practice.
3. Referring to student concerns about the extended teaching schedule (morning until afternoon) and the lack of intermediate preparatory period between exams (there are cases of two exams in one day).

Recommendations:

1. The External Evaluation Group recommends reviewing regulatory documents as a non-public institution to be in line with legislation on higher education in place (elections, appointments, mandates, etc.)
2. The concept of market research is focused within the country, while students expressed interest in the market abroad. The External Evaluation Group recommends for greater harmonization of market studies with the content of the curriculum and the expectations of students.
3. The External Evaluation Group recommends continuous improvement and harmonization of program documentation regarding the specification in the curriculum of the lectures and seminars and practices, or teaching hours in auditorium (45/60 or 48/64), as well as differentiation of the ECTS which are defined the same with 5 ECTS, except for the sixth semester where there are 5 courses with 6 ECTS each.
4. The External Evaluation Group recommends that the physical texts in the library be continuously enriched with professional publications of recent years related to political developments in Albania and the region, as well as subscriptions to scientific journals that exist in Albania.
5. Standard III.7 / Criterion 2, foreign language subjects (English, French, German, Italian and Turkish) dominate the program. The External Evaluation Group recommends that in addition to them, students should also get knowledge in the field of information technology, which can be easily applied in the two modern halls of computer labs. However, students in the subject of Research Methods that take place in the third semester acquire knowledge of two software, SPSS and Nvivo, in order to cast and process data obtained from the use of quantitative research methods.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X


